

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E SHTATË

VII

**Përktheu: Dr.Musli Verbani
Imam i QIKSHN-së**

Oslo, 2010

HYRJE

Falënderojmë Allahun, Krijuesin e gjithësisë. Nuk ka Zot tjetër pos Allahut, nuk mund të ndryshojë askush asgjë, përpos fuqisë së Allahut, dhe ne vetëm Allahut i mbështetemi.

Dhe ...

Përderisa gozhda fundoset në ujë, e kundërta anija lundron mbi sipërfaqen e ujit, e cila në vete i mban mijëra e mijëra gozhda. Po si është e mundur, gozhda e vogël fundoset në ujë, e anija e madhe jo ajo plot e përplot gozhda e nuk fundoset?!

Me këtë shembull i jepet përgjigjja lexueses muslimane, e cila ka pyetur:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Çdo grua, e cila parfumohet e pastaj del para një populli që ta ndiejnë erën e saj ajo është prostitutë dhe çdo shikim është (vepër) prostitucion në vete”. (Hakimi)

Vajza muslimane pyet: Përderisa vajza apo gruaja muslimane e nxit epshin e mashkullit. Unë pyes: Po mashkulli i parfumuar a nuk e nxit epshin e femrës?

Ne i themi: Femra e ka të ndaluar ta zbulojë trupin e saj për meshkuj, përpos para burrit të saj në shtëpinë e saj. Sepse prostitucion do të thotë akti imoral jashtëmartesor për t'i tërhequr zemrat e meshkujve dhe nxitjen e epsheve të tyre.

Hulumtimet psikologjike kanë vërtetuar se femra është më e ndjeshme dhe shumë vështirë e ka t'i sundojë emocionet e saja, përkundër mashkullit, i cili më me lehtësi i udhëheqë epshet e tij. Kështu që ai ndjenjat e tij i ka më shumë nën kontroll. Femra ka mundësi të prodhojë dashuri artificiale, ajo mund të aktrohet para personit me pason të sinqertë. Ndërsa mashkulli vështirë e ka dhe ai nuk mund të aktrojë para pasioneve të sinqertë. Aktrimi i tij paraqet shenjat në fytyrën e tij, në të folurit e tij. Përderisa femra mund të paraqitet me dashuri të flakët, mirëpo në brendësi mund të jetë e kundërta.

Nga kjo konkludohet se mashkulli apo djali i parfumuar nuk ndikon femra, ashtu siç ndikon femra e parfumuar te mashkulli.

Vështirë është të depërtohet në thellësinë e zemrës së femrës, mirëpo zemrat e meshkujve janë më të sinqerta. Nga kjo shohim se Kur'ani në ajetin e prostitucionit, në rend të parë e përshkruan femrën e pastaj mashkullin, përderisa në ajetet tjera mashkulli përshkruhet para femrave. Në suretun-Nurë Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Laviren dhe Lavirin t'i rrihni secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që i besoni Allahut dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh”. (En-Nurë, 2)

Po ashtu në suretun-Nurë Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Të këqijjat (gratë) janë për të këqijtë (meshkuj) dhe të këqijtë janë për të këqijjat. Të mirat (të ndershmet) për të mirët (të ndershmit). Të mirët (të ndershmit) për të mirat (të ndershmet)”. (En-Nurë, 26)

Nga të parët tanë është vërtetuar se femra asnjëherë nuk mund të bëjë prostitucion pa dëshirën e saj dhe pa pëlqimin e saj, ndërsa burri vështirë e ka që të kontaktojë seksualisht pa dëshirën e tij dhe kur është i detyruar.

XHINËT DHE MAGJIA

Pyetje: A mundet xhini të pengojë njeriun për të kryer marrëdhënie seksuale me gruan e tij? Dhe në ato raste a duhet shkuar te falltarët për ta çliruar nyjëtimin e pengesës.

Përgjigja: Po, e gjithë kjo është e mundur, magjia është e vërtetë dhe e vërteta e xhinëve në ndikimin e një gjëje të tillë është realitet. Allahu i Lartmadhëruar i jep disa veçori dhe specifika, sa që xhinët e llojit më të ulët të jenë të nënshtruar dhe të kontrolluar prej llojit të xhinëve të kategorisë më të lartë. Prej këtyre veçorive është që njeriu të ketë në përkujdesje atë lloj xhini, ashtu që xhini ka mundësi që kur femra të jetë e bukur ai të figurohet në trupin e saj si e keqe, e shëmtuar dhe e trishtuar, pra ai bëhet mbulesë e bukurisë së saj dhe shndërrohet në formën më të keqe sa që bukuria e saj në sy të burrit bëhet si të jetë majmun para tij.

Edhe e kundërta mundet me ndodhë, sa që në një grua e zakonshme të shndërrojë që ajo të duket si grua shumë e bukur, e dashur dhe ai ta dojë aq shumë, sa që i duket mbretëreshë e bukurisë.

Dhe kështu kur të martohet një burrë me një grua ai mundet të ndikojë në ftohje të marrëdhënies seksuale.

Të gjitha këto janë vetëm rrugët se si ndikon dhe si formëson xhini. Por unë gjithmonë këshilloj për të mos shkuar te falltarët për t'i çliruar nyejt e magjisë. Por burri le të këndojë te gruaja e tij “Kul huvall-llahun”, “Kul eudhu birabbil felek”, “Kul eudhu birabbil nas”. Kështu ai sigurohet nga lajka e shejtanit dhe e largon atë me lejen e Allahut, dhe atëherë xhini nuk mund të ndikojë në asgjë të keqe.

PASI QË RIZKU-FURNIZIMI ËSHTË I CAKTUAR, PSE TË PUNOHET?

Pyetje: Disa thonë: “Pasi që rizku-furnizimi është i caktuar, përse ta lodhi veten sa i përket çështjes së rizkut-furnizimit? Çka mendon Imami i nderuar për këtë?”

Përgjigje: I nderuari Shejh Shaëraviju u thotë: “Ajo çka i ndodhë njeriut në jetë është dy llojesh:

Lloji i parë, është ajo çka i vjen nga jashtë, aty është Kaderi-caktimi i Allahut. Nuk mundet të pengohet apo të kontrollohet. P.sh. Kur njeriu është në fabrikë, ose në ndonjë vend të caktuar dhe pastaj e humb punën pasi që fabrika bankroton ose e bën reduktimin e punëtorëve. Ose p.sh. kur njeriut i ndodhin me dhjetëra ngjarje në ditë, të cilat janë larg dëshirës së tij dhe nuk mund t'i ikë atyre ngjarjeve.

Përpos kësaj, është pjesa e zgjedhjes aty ku njeriu vepron me dëshirën e tij, aty ku Zoti i Lartmadhëruar i ka vendosur rregullat dhe ligjet. Ai, i cili punon arrin frytin e punës së tij. Për çdo punë, veprim dhe angazhim shpërblehesh ose paguhet. Pra, rizku-furnizimi gjendet në tokë. Mirëpo çështja është se a vjen te ti në tërësi. Si p.sh. ti blen harxhin mujor për shtëpinë tënde, e vendosë në vendin e posaçëm dhe në frigorifer, pra furnizimi gjendet në shtëpinë tënde, të gjitha llojet e ushqimit dhe të gjitha elementet janë të sistemuar dhe janë nën kompetencën tënde. Ata, të cilët thotë “i mbështetemi Zotit (tevekkeln)” dhe rizkut ia japin po këtë kuptim, mu ata janë të cilët dëshirojnë të ikin nga çdo punë e vështirë dhe të mundimshme, ndërsa nëse është puna e lehtë, pa lodhje dhe pa ndonjë vështirësi, atëherë nuk besojnë në “Tevekkul – mbështetje në Zotin”, ata e ngritin veten e

tyre aq lartë sa që mundohen t'i ikin çdo lodhjeje, çdo mundimi, ai mbështetet te Zoti “jetevekkel”, derisa të arrijë furnizimi (rizku) te ata, por, derisa të vendoset ushqimi para tyre, ata e harrojnë menjëherë se çka kanë thënë më herët dhe menjëherë me hezitim fillojnë ta marrin ushqimin, pra ata me të shpejtë dhe me angazhim e marrin ushqimin derisa të ngopen. E pse pra nuk mbështeten te Zoti “jetevekkelune” derisa të hyjë ushqimi vetë në fytin dhe barkun e tyre pa angazhimin e tyre, pse nuk pret që ushqimi t'u afrohet dhe të hyjë në gojën e tyre, dhe të futet në bark derisa të mbushen barqet e tyre. Pra, ata janë mbështetur në ato çështje, të cilat nevojitet mund dhe angazhim, ndërsa në çështjet, të cilat janë të lezetshme, të shijshme dhe të gatshme ti nuk ke bërë “tevekkul – mbështetje te Zoti”. Po të kishe qenë i sinqertë në atë që thua, pse nuk ke bërë “tevekkul-mbështetje” kur të është vendosur ushqimi para teje, të kishe vazhduar të qëndrosh ulur pa lëvizje dhe ta kishe pritur për të ardhur ushqimi në gojë.

Nga këtu shohim se Allahu i Lartmadhëruar na ka mundësuar të gjitha kushtet dhe rrethanat e furnizimit në tokë, saktësisht ashtu siç i thotë pronari i shtëpisë punëtores apo përgjegjes: Për në muaj çdo gjë që të nevojitet e keni në depo, ndërsa tjetër është çështja se ajo nuk dëshiron ta lodhë veten dhe ta përgatit ushqimin.

Kështu thotë edhe fjala e urtë: “Pjesët organike të trupit punojnë, ndërsa zemrat mbështeten”. Mbështetja është cilësi e zemrave dhe nuk është cilësi e pjesëve organike, pse prej pjesëve të trupit kërkohet të vepron.

Shejh Shaëraviju në shumë raste e kam dëgjuar duke thënë me urtësi: “Rizku (furnizimi) që të takon ty si në pasuri ashtu edhe në reputacion e di më mirë se ti vendin se ku do të jesh në të ardhmen”. Kjo fjalë e urtë, të cilën e ka thënë Imami, ka domethënie të rëndësishme, është fjalë që shkëlqen dhe udhëzon dhe është fjalë, e cila bën që njeriu të kuptojë dhe të angazhohet për rizkun (furnizimin) e tij, por jo të hezitojë, të ngutet, të shikojë për të përshpejtuar diçka, sepse rizku (furnizimi) është i përcaktuar dhe i emëruar në adresë të caktuar dhe nuk mund të kalojë në adresë të tjetërkujt.

Imami i mirënjohur komenton ajetin e Zotit të Lartmadhëruar: “Dhe në qiell është furnizimi i juaj dhe ajo çka u është premtuar”, Zoti i Lartmadhëruar çështjen e rizkur e ka lënë në qiell, ashtu që njerëzit të mos jenë në gjendje të arrijnë atje. Pra, kuptimi i ajetit është: Oj krijesë, furnizimi yt është në qiell ku duart tua nuk mund të arrijnë aty, mirëpo të duhet të punosh, të mundohesh, të angazhohesh e të lodhesh që të vijë furnizimi yt, të cilin e ka caktuar Zoti për ty. Pjesa e ajetit “furnizimi juaj” na vërteton qartë se fjala “ku furnizimi” është i ndarë dhe i përkufizuar posaçërisht për ju dhe se furnizimi i njeriut është i premtuar për angazhuesin dhe punuesin dhe për atë, i cili aktivizohet dhe vepron dhe nuk duhet të qëndrojë i ngurtë para rrethanave dhe peripecive të ndryshme.

DREJTËSIA E VËRTËTË

Gjatë historisë njerëzore edhe sot e vërteta dhe e drejta në mes njerëzve nuk realizohet ,gjë që është vështirë që njeriu të ketë qetësi, pra a na tregon ç'është drejtësia njerëzore?

Përgjigje: Drejtësia e vërtetë është ajo të cilën na e ka obliguar Allahu neve. Drejtësia nuk është tipar të cilin i drejti e bën me vetëdëshirë. Por me drejtësi nënkuptohet ka i drejti i përmbahet kandarit të Tjetrit i cili e ka vendosë atë ne peshojë e Ai është Allahu i Lartmadhëruar. I Drejti nuk është ai i cili me vullnet sipas dëshirës së tij me praktikuar atë që e parasheh por praktikimin i asaj çka e ka përcaktuar dhe e ka vendosë Krijuesi. Për këtë arsye kam thënë dhe them se specifika e besimit nuk është ajo që ti ti ose unë vazhdimisht të gjykojmë për veten tonë ,por unë dhe ti me qenë të gjykuar prej Allahut për veten tonë.

PROBLEMI MJEKËSOR I MASTURBACIONIT (VETËKËNAQËSA)

Masturbimi a është hallall apo haram? Dhe vajza apo djali i cili bën një veprim të tillë a e kaplon sëmundja apo paaftësia siç thonë disa prej njerëzve, dhe nëse teprohet a është e dëmshme për organizmin, pra për pjesët e tjera të trupit?

Përgjigjja:

- Masturbacioni është edukatë e keqe, kur të rinjtë dhe të rejtat pra në kohën e pubertetit e bëjnë një gjë të tillë për shkak të ndikimit të hormoneve seksuale të cilat janë tepër aktiv në trupin e njeriut.

Ndoshta dëshira e madhe për seks shtihet për shkak të shtimit të këtyre hormoneve në njërin anë dhe ndalesa fetare për lirimin e tyre të paligjshëm e shtynjë që ato patjetër të lirohen prej vendit të tyre ku tubohen dhe shtohen , kjo është një gjë që zakonisht përhapet, mirëpo i riu dhe e reja të jenë tepër nervoz , i cili e tepron në të gjitha lëvizjet e jetës së tij.

E kemi për detyrë me thënë se Masturbacioni nuk shkakton ndonjë sëmundje në organizëm por është një traditë e keqe ,ves i keq dhe zakonisht paraqitet tek ata të cilët kanë kohë të lirë dhe nuk kanë kurrfarë përgjegjësie në jetë.

Nuk është e vërtetë se masturbacioni verbëron njeriun , apo e bën njeriun të paaftë por kjo është një hiporbolizim.

Largimi prej një veprimi të tillë bëhet duke e angazhuar me diçka duke agjëruar, duke lexuar Kur'an deri sa të plotësohen kushtet e martesës dhe ky është ilaçi natyror i këtij problemi.

PASRTIMI I NDËRSJELLTË BASHKSHORTOR

A lejohet që gruaja ta pastrojë burrin e sajë?

Përgjigje: Ajsha r.a Transmeton se: Është kthyer i dërguari i Allahut s.a.v.s nga një përcjellje kufome ndërsa kishte kokëdhimbje e i ka thënë: më dhemb koka. I Dërguari i Allahut më tha :Po edhe mua po më dhemb koka, por çka mendon sikur ti të vdesësh para meje e unë të të pastroj, të të mbshtjell me kefin e pastaj të ta fali namazin e xhenazes dhe të të varrosi?!

(*TRANSMETON
AHMEDI*)

Hadithi tregon se gruaja e pastron burrin e saj kur ai vdes ndërsa analog me këtë edhe e kundërta (burri e pastron gruan).Transmetohet se Esma e ka pastruar Ebu Bekrin, dhe po ashtu Fatimja e ka pastruar Aliun, Zoti i pastë nderuar. Kjo është dëshmia se ky është argument unanim (IXHMAI), sepse asnjëri prej sahabëve nuk e ka kundërshtuar veprimin e tyre.

PËRGOJIMI

Pyetje: Çka është përgojimi,dhe a është e vërtetë se me përgojuar mëkatarin e madh (FASIKUN) nuk është mëkat?

Përgjigje: Muhamedi a.s. ka thënë: „ A e dini se ç’është përgojimi? Por askush nuk e di më së miri se Allahu dhe i Dërguari i Tij. Pastaj Muhamedi a.s. ka thënë "Përgojimi është

me ia përmend emrin vëllait tënd atë që nuk dëshiron"

I kanë thënë: Po nëse është e vërtetë atë çka ka vepruar vëllai im? Është përgjigjur: Nëse është e vërtetë atë që e thua mu ajo është përgojim, po nëse nuk është e vërtetë atëherë ti ke shpifë për të.

E KA TRANSMETU

AHMEDI

Po ashtu është transmetuar se një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. :çka është përgojimi, me ç'rast është përgjigjur: Me ia përmend emrin vëllait tënd atë që nuk dëshiron që ai me dëgjuar" Po o i Dërguari i Allahut edhe nëse është e vërtetë atë që e them" Ka thënë: Nëse e thua jo të vërtetën ti veç ke shpifur për të/

*TRANSMETON AHMEDI DHE
MALIKU*

HAXHI I GRUAS PA LEJEN E BURRIT TË SAJ

A lejohet që gruaja ta kryej haxhin pa pëlqimin dhe pa lejen e burrit të saj?

Nuk është e pëlqyeshme që gruaja të kërkojë leje prej burrit të saj për kryerjen e haxhit farz. Por edhe nëse e pyet ,dhe e lejon e kryen haxhin ,sepse burri nuk ka të drejtë me ndalu apo me pengu gruan e tijë për ta kryer haxhin farz. Sepse haxhi është iradet, i cili është bërë obligim për te, dhe nuk lejohet të dëgjohe krijesa në mëkatimin ndaj Krijuesit.

Ajo duhet që sa më shpejtë të kryej obligimin që të lirohet nga obligimi i saj sikurse ajo e fal namazin në fillim të kohës e ai nuk ka të drejtë ta ndalojë. Kështu vepron edhe me rastin e haxhit të përбетimit. Ndërsa sa i përket haxhit vullnetarë ai ka të drejtë ta pengoj.

E KAN PA KUR'ANIN DHE NUK I KAN BESU

Qysh i ka luftuar Kur'ani zemrat e pabesimtarëve edhe përkundër asaj që ata nuk e kanë besuar prej mllëfit dhe kryelartësisë së tyre?

Imami i nderuar Shaëraviju thotë:

Arabët e parë që në fillim e kanë pranuar këtë çështje por jo pse e kanë dashur, as për atë se është natyrshmëri që ata dashtë a pa dashtë ta pranojnë ,por nga shkakut se ata e kanë pranuar Kur'anin duke arsyetuar vetëm se ai Kur'ani pse i ka zbritur Muhamedit s.a.v.s. pra pse ai është njeriu i gabuar sipas mendimit të tyre për ti zbritur Kur'ani. Këtë e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an kur thotë: "Dhe sikur ti kishte zbritur ky Kur'an një njeriu prej vendeve me famë".

*(EZ-
ZUHRUF 21)*

Pra ata nuk e kanë kundërshtuar Kur'anin si libër ata në mendje dhe gjokset e tyre ka arritur mirëpo kundërshtimi është në atë se pse i ka zbritur këtij pejgamberi(Muhamedit a.s.)

pra ata e kanë ndryshuar esencën e temës sepse tema ka qenë se Kur'ani ka kërkuar kundërshtim? mirëpo kundërshtimi i tyre nuk ka qenë në vetë Kur'anin por atë të cilit

i është zbritur Kur'ani. Për këtë arsye ne shohim se ata hamenden ndonjëherë thonë: Është magji. Thonë: Gjithsesi magji është. Ne u themi atyre : I magjepsuri a ka të drejtë zgjedhje prej magjistarit? Kur një magjistar dëshiron me magjepsur njeriun a mundet i magjepsuri ta refuzojë atë magji. Por nëse e ka magjeps një popull (një pjesë të njerëzve, pse nuk ju ka magjeps juve o ju kundërshtarë. Me këtë argumentojmë se Kur'ani nuk është magji sepse po të kishte qenë magji do t'ju kishte magjepsur juve.

Ndonjëherë thonë: Është poezi. Ne u themi atyre bëni një krahasim në mes të metodikës së Kur'anit dhe metodikës poetike, ju jeni të njohur për këtë çështje, pra, a është Kur'ani prej llojit të poezisë?

Ndonjëherë thonë është iluzion. Ne u themi bëni krahasim prej iluzionit dhe Kur'anit.

Vetëm se Kur'ani kur ti paraqet këto çështje i paraqet me argumente bindëse të cilat argumente bindin shpirtin e pastër dhe natyrorë ku thotë:

Nuk është fjalë (thurje) poeti, pak po besojnë, as thënje iluzionisti (magjistar) pak po logjikojnë.

(EL-
HAKATU 41.42)

DITA E MARTË DHE DITA E ENJTE

Cila është vlera e agjërimit të ditës së martë dhe ditës së enjte ,dhe pse e ka specifiku i Dërguari i Allahut s.a.v.s.

Përgjigje: Kur është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s për agjërimitin e ditës së martë është përgjigjur: „Është dita të cilën kam lindur ,dhe në të cilën më ka zbritur Kur'ani.

*E KA REGJISTRU
AHMEDI*

I ka thënë Usame r.a të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. „O i Dërguari i Allahut ti po agjëron aq shumë sa që po mendojmë se nuk do ta ndërpresësh asnjëherë agjërimitin dhe po ashtu nuk po agjëron sa që po mendojmë se asnjëherë nuk do të agjërosh përpos kur po janë dy ditë ti gjithnjë po agjëron. Po cilat janë ato dy ditë? Tha: Dita e martë dhe dita e enjte. Tha: Këto dy ditë janë ditët në të cilat i paraqiten Allahut Krijuesit të botëve veprat tona ,ndërsa unë dëshiroj që veprat e mia të paraqiten Allahut duke qenë agjerueshëm.

*E KA REGJISTRU
AHMEDI.*

SHKURTIMI I FLOKËVE TË FERMAVE

A lejohet femra ti shkurtoj flokët e saj?

Është e ndaluar që femra të rruaj kokën e sajë në bazë të thënies së Aliut r.a.: E ka ndaluar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. që femra ta rruaj kokën e sajë"

*TRANSMETON NESAIJU DHE
TERMIDHIU.*

Kjo nga shkakut se të rruarit e kokës i ngjason mashkullit dhe kalon prej suazës femërore në atë mashkullore ,dhe në shëmtim të natyrshmerisë së saj, e kjo është haram, ashtu siç e transmeton Ibn Abasi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: I ka mallkuar Allahu përgjasuesit e

meshkujve në femra dhe përgjasueset e femrave në meshkuj”.

*TRANSMETOJN TË PESTËT POS
MUSLIMIT*

Mirëpo nëse paraqitet infektimi në mosshkurtimin apo mosrruarjen e sajë prej insekteve e të ngjashme dhe i dobësohet lëkura kjo është domosdoshmëri, e cila e lejon shkurtimin e flokëve të sajë ashtu siq e transmeton në koleksionin e Ahmedit se kur është pyetur për fermën e cila nuk ka mundur të shëroj kokën e saj pa i shkurtuar flokët. Kur ka pyetur pse? Ka marrë përgjigje se nuk mundet të depërtojë yndyra në lëkurën e saj. Ka thënë: “Nëse është domosdoshmëri shpresoj se nuk ka ndonjë pengesë, she nuk është keq”

ÇKA KA PA I DËRGUARI I ALLAHUT NATËN E ISRASË DHE MIRAXHIT

Çka ka pa i Dërguari i Allahut s.a.v.s natën e miraxhit dhe cilat janë argumentet si p.sh. për pirjen e qumështit dhe mos pirjen e alkoolit dhe a ka ndonjë lidhje kjo dukuri me çështjen obligative.

I nderuari Muhamed Mteveli Sheëraviju thotë:

Kanë thënë se: mendja është ekzekutiv i obligimeve të pranuar prej Allahut ,ndërsa alkooli është dehje e mendjes .Sepse Allahu detyrat ia obligon mendjes e cila i pranon obligime,sepse për të çmendurin nuk ka çështje obligative sepse atëherë mjeti i cili ka të drejtë zgjedhje është paralizuar sepse mendja është ajo e cila zgjedh në mes sendeve e nëse është çështje për diçka nuk ka drejtë zgjedhje atëherë mendja aty mendja nuk ka çka të kërkojë,dhe derisa ekziston çështja zgjedhje në mes të dy sendeve atëherë patjetër duhet me qenë mendja e shëndoshë ,dhe vaga e drejtë dhe sikur që njeriu të përdorte alkoolin do ta prishte këtë begati të madhe ,pranimin e besimit në Allahun dhe qe në fazën e parë ka dashtë Allahu me thënë: natyrshmëria është e pastër dhe e shëndoshë dhe atë e prishë veprimtaria e juaj. Qumështin të cilin e ka pi Pejgameri s.a.v.s. dhe nuk ka pi alkool është se qumështi është burim(lëndë) i natyrshmërisë ndërsa ju alkoolin e keni prishur sepse ju e prodhoni ,pra me duart tuaja keni ndërhyrë dhe keni përpunuar atë pasi ka qenë begati e pastër ju e keni bërë të ndotur dhe e shpini te ekzekutivi i obligimit te Allahut pra tek mendja. Për këtë arsye begatia e madhe është kthyer kundër jush.

Kjo ka qenë çështja e parë të cilën e ka pa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. natën e miraxhit, pas kësaj vjen faza e dyte, ku i Dërguari i Allahut s.a.v.s. sheh një popull ku aty mbillnin dhe menjëherë mbilidhnin dhe kjo përsëritej vazhdimisht. E ka pyetur Xhiblrin kush janë këta?I është përgjigjur:Këta janë luftëtarë në rrugën e Allahut. Lufta në rrugën e Allahut

është përkushtimi dhe angazhimi në thirrjen e Pejgamerit, i cili ka zbrit prej Allahut te njerëzit për me i udhëzuar në atë rrugë andaj këta luftëtarë ne rrugë të Allahut patjetër duhet të ketë fryte të llojlojshme. Po pse fryte të llojlojshme? Sepse ata angazhohen me pasuri të tyre, me shpirtra të tyre .E premtimi i Allahut është harmonik në shpërblimin në bazë të punës dhe angazhimit ,e kjo do të thotë shpërblim i vazhdueshëm. Dhe çdo herë kur të luftosh ne rrugën e Allahut ,e prej aty përhapet feja e Allahut ti do të kesh shpërblim të vazhdueshëm.

Pra këtë e ka pa i Dërguari i Allahut s.a.v.s për me sqaruar të vërtetën e muxhahidinëve dhe shpërblimin e tyre „Dhe çka do të shpenzoni qoftë e vogël shpërblimi pason"

Pas kësaj faze Allahu i Lartmadhëruar i paraqet një pasqyrë tjetër të botës me një grua plakë e mbushur me stoli.E kur e ka pyetur Xhibrilin :Çka është kjo i është përgjigjur: Nuk ka mbetur prej botës më shumë se sa i ka mbet kësaj plake. Sikur me këtë Muhamedi a.s. ka dashur të thotë:Unë e kjo botë do të jemi sikur jeta e kësaj plake .pra sa ka mbet jeta e kësaj plake aq ka mbet edhe koha deri në ditën e kijametit. E pasi kësaj plake i ka mbetur shumë pak kohë mos u angazhoni shumë në të. Jepi rëndësi aq sa ke me jetuar në te. Duhet me punuar për këtë botë aq sa ke për të jetuar në te. Të mirat në këtë botë janë të kufizuara brenda kufijve të mundësive të mia,mirëpo në botën tjetër nuk janë të përkufizuara sepse aty është mundësia dhe fuqia e Allahut.

Çështje tjetër çka ka pa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. është se ka pa njerëz të cilëve me gërshërë ua prenin buzët dhe gjuhët e tyre. Pse? Sepse buzët dhe gjuha janë mjete komunikimi. E kur e ka pyetur kush janë këta o Xhibril i është përgjigjur: Këta janë ligjëruesit e fitimeve. Ata janë të cilët thonë atë që nuk veprojnë. Fjalët e tyre janë më të ëmbla se mjalta, ndërsa veprat më të hidhëta se hidhëtia e rrënjëve, sepse shkaktojnë fitne, sepse për ato mendohet se janë thirrës ndërsa ata janë ligjërues ,apo më mirë shkaktues të fitneve. Ata me të vërtetë flasin dhe njerëzit i dëgjojnë ata,por veprimtaria e tyre është në kundërshtim me fjalët e tyre ,atëherë njerëzit i krahasojnë fjalët e me veprën e tyre dhe kuptojnë se fjala flitet ,e vepra veprohet dhe kur të jetë në kundërshtim me sjelljet atëherë çdo gjë çrregullohet.

Pastaj Imami i nderuar thotë:Këta janë disa çështje të cilat i ka pa i Dërguari i Allahut .s.a.v.s. e prej tyre ku Muhamedi a.s është taku me pejgamerët, ku shumica e tyre kanë qenë prej beni Israilit. Në atë natë është bërë obligim namazi. Shejh Shaëravi tregon urtësinë dhe arsyen e shikimit të këtyre çështjeve. Është një mjet prej mjeteve sqaruese për disa çështje të rëndësishme ,të cilat kanë të bëjnë me thirrjen islame,e pas kësaj vijon çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me pasurinë nderin dhe fjalët.

Ajo çka ka të bëjë me pasurinë ,Allahu i Lartmadhëruar ia ka paraqitur te Dërguarit të Allahut s.a.v.s një popull i cili nxitonte mbi lumë me gjak e pastaj gjuheshim me gurë. Për këtë popull e ka pyet Xhibrilin:Po kush janë këta? I është përgjigjur: Ushqyesit me mjete të kamatës.

Pastaj pasqyrimi i nderit.Është interesant se përgojimi i cili i është paraqitur të Dërguarit të Allahut s.a.v.s është paraqitur në tri forma: Njëherë e ka pa një popull me thonë të hekurt të cilët i shqyenin fytyrat e tyre.Kur ka pyetur për ta,ka marrë përgjigje se ata janë njerëz që përgojnë të tjerët. Ka pa edhe formën tjetër ku ata merrnin mishin e njerëzve dhe e hanin, herën tjetër ka pa duke marrë mishin e njerëzve të vdekur duke ngrënë i është paraqitur në tri forma për shkak të krimin të madh të përgojimit.

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar ka paraqitur një pasqyrë tjetër e ajo është prostitucioni në formën më të egër. Ka pa një popull të cilët para vete kishin mish të pastër e nuk e hanin atë mish të mirë, por shkonin e hanin mishin e ndotur të përlyer dhe jo të pastër. Kur ka pyetur për këtë ka marrë përgjigje:Njeriu i cili gruan e tij e ka hallall për kontributin

seksual dhe shkon,ndërsa ai e lë atë dhe shkon te gruaja e huaj dhe kontakton të cilën e ka haram ,ose gruaja e cila ka burrin që në kontakt me të e ka hallall ndërsa shkon me burrë të huaj të cilin e ka haram.

Sa i përket fjalëve edhe për të ka pa Muhamedi a.s. .

Pra ka pa një lopë të madhe e cila del prej një vrimë e dëshiron prapë të hyjë në atë vrimë por nuk mundet .Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka pyet për këtë ka marrë përgjigje:Kjo është sikur një njeri e thotë një fjalë pastaj dëshiron ta kthej mbrapa por nuk mundet.

Pas kësaj Muhamedi a.s . ka parë diçka tjetër :Ka parë një njeri i cili ka një barrë të rëndë në shpinën e tij të cilën nuk mundë ta bartë mirëpo kësaj radhe e zgjat dorën për me marrë edhe një barrë tjetër e me vendosë në kraharorin e tij. Kur ka pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për këtë ka marrë përgjigje:Ata janë të cilët marrin detyra me përgjegjësi (emanete) e janë të paaftë me i kryer ata,mirëpo përkundër kësaj ata dëshirojnë përgjegjësi tjera e emanete tjera.

Të gjitha këto ndodhi të cilat i ka pa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe sqarimet e atyre ndodhive ,është që besimtari me kuptuar ose dënimin e atyre të cilët veprojnë ashtu në formën më të egër ,dhe me i largu sa më parë ato dukuri negative. Prej ndodhive që ka pa i Dërguari i Allahut s.a.v.s është se ka pa një popull,kokat ë të cilëve copëtoheshin me gurë dhe sa herë u copëtoheshin u ktheheshin në gjendjen e mëparshme pastaj u bihej me gurë dhe prapë u copëtoheshin kokat. Kur ka pyet;Kush janë këta o Xhibril? Merr përgjigje:Këta janë mosfalësit e namazit, e vërteta pse copëtoheshin kokat e tyre është pse namazi është proces i mendjes, kur ta përqendroj njeriu mendjen për me u falë ai falet pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat dhe angazhimin e tij.

Pas obligimit të namazit për Umetin e Muhamedit s.a.v.s. Muhamedi a.s shkon e takohet me Musa a.s. për t'u lehtësuar namazi deri sa mbetet në pesë kohë .E tëra tregon për vlerën dhe rëndësinë që ka namazi.

ZËRI I FEMRËS

-A është zëri i femrës turpëri?

Zëri i femrës nuk është turpëri i pjesës së turpshme të saj vetëm nëse ka për qëllim që me zërin e saj të hollë me e tërheq, me i përfutur dhe me josh njerëzit, sepse me hollësimin e zërit të saj i traumatizon burrat kur artistohet apo aktërohet për së tepërmi e për këtë kemi argument fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

„Dhe të mos e keqpërdornin zërin e tyre me fjalë ashtu që ai i cili e ka zemrën e sëmurë të lakmojë në të"

EL-AHZAB 32

Në fikhun e katër medhhebeve thuhet:

Zëri i femrës nuk është turpëri sepse gratë e pejgamberit kanë folur, dhe kanë biseduar me sahabët dhe sahabët i kanë dëgjuar ata dhe prej tyre kanë mësuar fenë.

Mirëpo është haram me dëgjuar zërin e sajë nëse njeri frikohet se mos po traumatizohet

edhe me lexim të Kur'anit prej sajë. Gruaja ka qenë ajo kur ka polemizuar me Emirin e besimtarëve Omer Ibn Hatabin r.a. kur ka dashtë me përkufizuar „MEHRIN" dhe ia ka tregu ajetin Kur'anor . „Dhe në çoftë se doni të merrni ndonjë grua tjetër në vend të asaj që keni (por keni vendosë ta lëshoni) dhe i keni dhënë pasuri të papërcaktuar (KINTAR) si mehr mos i merrni asaj aspak.

EN-NISA 20

SO E HJEKIM PERDËN E SYVE

A ka ndërlidhmëni në mes të ligjeve të raportit shpirt-trup derisa njeriu është në gjumë, kur është zgjuar, kur vdes dhe në rastin për të cilin Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe Ne kemi heq sot perden e syve tu dhe sot sheh me shikim tjetër të veçante”.

Përgjigjja: Po kur njeriu kalon prej momentit të jetës në momentin e vdekjes dhe shpirti i arrin në fyt e ju në atë moment shihni. Zoti i Lartmadhëruar thotë: Ti veç ke qenë i panjohur dhe nuk ke pasur kurrfarë diturie për këtë ditë, mirëpo pasi që e kemi hequr perden e syve tu sot sheh shqim tjetër gjëra që si ke parë më herët .

Posa të kalojë njeriu prej momentit të vdekjes në momentin e kalimit në botën tjetër sheh gjëra të cilat kurrë më parë nuk i ka pa më herët edhe pse ende është gjallë dhe shpirti është në të.

AI ËSHTË PENG I BORGJIT TË TIJ

SI është çështja me personin i cili vdes dhe ka pas dëshirë me la borxhin e tij?

Përgjigjja: Një njeri ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. :Nëse unë luftoj me veten time me pasurinë time ,me vendosmëri drejtpërdrejtë në front pa u tremb fare dhe pa ia kthyer shpinën armikut, a do të hyjë në xhenet?

-Po Këtë e ka përsëritë dy apo tri herë pastaj ka vazhduar: Vetëm nëse vdes dhe nuk e ke la ndonjë borgj tëndin"Këtë e ka tregu bindshëm duke e sqaruar “Borxhi” Për Zotin në dorë të cilit është shpirti im nëse njeriu lufton në rrugë të Allahut nuk do të hyjë në xhenet derisa të lajë borxhin e tij"

E ka regjistruar „AHMEDI

Një njeri e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për një vëlla të tij, i cili ka vdekur dhe ka pas borxh pa e kryer. Muhamedi a.s. ka thënë: Ai është peng i borxhit të tij. Laje borxhin për të:Ai prapë ka thënë: Po unë i kam la borxhet e tij ,përpos një borxh praj dy dinarëve të cilën e kërkon një grua ,por ajo nuk ka argumente se i ka pasur borxh asaj. Muhamedi a.s. ka thënë: „Jepja dy dinarë sepse ajo ka të drejtë"

E ka regjistruar „AHMEDI

Ky është argument se kujdestari nëse merr vesh për ndonjë borxh të vdekurit e ka vaxhib me ia la borxhin edhe nëse nuk ka argument se i ka borxh.

INVESTIMI NË MJETE TË CILAT SHPENZOHEN NË KAMATË

Kam aksionuar në njërën prej shoqatave për ndihmë banesore. Kryesia e zgjedhur prej kuvendit e kësaj shoqate ka vendosë me marrë kredi prej investitorëve për me i mbuluar disa investime. Ndërsa në anën tjetër ka (profitar) debitu prej pasurisë së shoqatës duke deponuar në banka me kredi. Po ashtu shoqata merr kredi kooperimi në anën tjetër me kamatë në emër të shoqërive aksionare për me ndërtuar objekte të veçanta për shoqata.

Kjo lloj veprimtarie e ndaluar ,a bie në barrë të Kuvendit menagjues të shoqatës apo bie në barrë të të gjithë anëtarëve?

Me fjalën tjera përqindja e vogël e kamatës me shoqëri aksionare konsiderohet investim i shpenzimit apo kamatë?

Përgjigjja: Të gjitha këto veprimtari konsiderohen kamatë, dhe që të gjithë kanë përgjegjësi të veprimtarisë me kamatë, ndërsa nëse ti nuk ke ditur për veprimtarinë me kamatë nuk ke përgjegjësi. Kjo është e njëjtë sikurse një njeri ka ble banesë prej mjeteve me kamatë ose me para të vjedhura atëherë shitësi nuk ka përgjegjësi sepse nuk ka ditur për burimin e atyre mjeteve. Përqindja e kamatës qoftë e madhe qoftë e vogël pa kurrfarë dyshimi është kamatë.

LLOJET E IDETEVE.

Sa lloje të Ideti ekzistojnë:

_Llojet e Idetit janë katër:

- Ideti i gruas e cila ka menstruacione e ajo është prej tri menstruacioneve do të thotë pastrimi prej atyre tri menstruacioneve

- Ideti i gruas e cila nuk ka menstruacione e ideti i saj është tre muaj

-Ideti i gruas së vilës i ka vdekur burri, ideti i sajë është katër muaj e dhjetë ditë nëse nuk është shtatzënë

-Ideti i shtatzënë është deri sa të lindë.

MIRËSIA NDAJ PRINDËRVE PAS VDEKJES SË TYRE

Si është mënyra e nderimit të prindërve pas vdekjes së tyre?

-Një njeri prej ensarëve e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. A mund t'i nderoj diç prindërit pas vdekjes së tyre ?

-Muhamedi a.s. është përgjigjur: Në katër mënyra të luturit për ata , të kërkuarit falje për ta ,të kryerit e premtimeve të tyre ,nderimi i shokëve të tyre .Lidhja farefisnore e cila lidhje vjen drejtpërdrejtë prej tyre. Kjo është detyra, e cila ka mbetur me i nderu ata pas vdekjes së tyre .

*Transmeton
Imam Ahmedi*

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. :

- Cila është detyra e fëmijëve ndaj prindërve?

Është përgjigjur:Ata janë Xheneti dhe Xhehenemi yt.

Transmeton Ibn Maxhe

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për mirësinë ndaj prindërve, e ai është përgjigjur:

Mjerë për ty po a e ke gjallë. Po! Mjerë për ty po rri pranë këmbëve të saj se aty e ke Xhenetin .

Transmeton Ibn Maxhe

Muhamedi a.s. ka thënë :

Më së shumti më habit fakti i personave të cilët i hane prindërit e moshuar dhe në pleqëri e nuk e fitojnë Xhenetin e tyre .

Hadith Sahih

KALIMI I MENDJES DIKUND TJETËR GJATË NAMAZIT

Si është çështja e kalimit të vetëdijes diku tjetër pa qëllim gjatë namazit?

-Çështja e kalimit të mendjes diku tjetër gjatë namazit është dukuri e njohur ,mirëpo kjo

çështje në vetvete nuk përkufizohet si dukuri normale , por veprimi i dëshirës së vetë njeriut.

Gjatë namazit , të vjen shejtani dhe ta fsheh mendjen tënde , pra e meta është se ti nuk ke kujdes në atë çka je përqendruar. Shejtani ta jep perin pastaj ti me mendjen tënde shkon nëpër atë pe dhe jeton aty pra çështja është se ai nuk ta ka marrë mendjen , por mendja shkon aty .Kur ka qenë diskutimi mes Allahut dhe Iblisit , dhe kur Iblisi ka refuzuar me i bë sexhde Ademit (pa qartë).A mos i ka thënë Iblisi Allahut se do të qëndroj te rruga e shtrembët e robërve të Tij. Jo. Por çka i ka thënë?:Do të qëndroj te rruga e drejtë e robërve Tu ,sepse ai i cili është në rrugë të gabuar shejtani s'ka nevojë me shkuar te ai .Shejtani nuk qëndron në vendet e pirjes së alkoolit e ka dehen njerëzit , pse ata veç mendjen e kanë të dehur ,të humbur por çka bën?Shkon e qëndron në derë të xhamisë e shejtani nuk rri aty me këshilla por kur ka thënë do të qëndroj pranë tyre ,aty ku ata janë në rrugë të drejtë... Çasti i namazit është çasti ku njeriu është më së afërti me Allahun ,ndërsa shejtani këtë afërsi mes robit dhe Allahut do me shkatërruar , dhe për këtë arsye vjen në mendjen tënde . Lidhjen të cilën nuk ka mundë me zgjidhë para namazit tenton me prishë gjatë namazit. Mossuksesi humbja e njeriut në ato momente është se shejtani hulumton në forma dhe mënyra me zgjidhë gjatë namazit .Dhe sikur njeriu në ato momente kur i ndërhysh dhe e prekë shejtani(fjala në ato momente i tregohet qartë se shejtani nuk është gjithmonë me ty,,dhe ata të cilët i frikohen Zotit dhe janë të devotshëm ,kur t'iu ndërhysh shejtani e i prekë , menjëherë bëhen të kujdesshëm e vërejnë ,dhe ata janë vizitorët me të mirë) , thotë: „I mbështetem Allahut nga shejtani i mallkuar dhe derisa Zoti i Lartmadhëruar më ka thënë mua ,, dhe në ato momente kur shejtani ndërhysh dhe të ndërlidhë diçka ti kërko mbrojtje prej Allahut që nga Ai qastë kur e thua këtë shejtani pengohet sepse shejtani asgjë nuk mund të bëjë para Krijuesit të tij.

Por nëse unë nuk ballafaqohem me të , cili do të ishte rezultati ?

Ata të cilët e pasojnë Iblisin ,u vjen në ditën e kijameti t u thotë,, Ju keni qenë të pakujdesshëm o mëkatarë ,pse ?Mos kam pasur ndonjë pushtet mbi ju,,Unë vetëm u kam ftuar dhe ju mu keni përgjigjur. Ja veç keni pasur shenja dhe vërejtje për mos me më pasuar ,ndërsa unë nuk kam pasur argumente bindëse dhe pushtet mbi ju. Nëse ke ardhur tek unë me mu ankuar tek unë për mëkatin tënd , çka të them unë ty?Kjo është forca e argumentit ,unë nuk kam pasur diçka të veçantë me të joshë që me shpresuar diçka ,por as nuk kam pasur mundësi me të detyruar, pra ti nuk i ke as argumentin se ke qene i detyruar as argumentin se të kam premtuar diçka. Pra,,Unë nuk kam pasur pushtet mbi ju ,vetëm se u kam ftuar e ju mu keni përgjigjur mos më akuzoni dhe mos me mallkoni mua por akuzoni e mallkoni veten tuaj. Ta sjellim një shembull të Ebu Hanifes r.a. i cili ka ditë me dhënë përgjigje për çdo rast dhe për çdo person .

Ka shikuar një njeri dhe i ka thënë ,,O Imam ! Kam pasur pasuri dhe e kam fshehur në tokë ,mirëpo e kam harruar vendin, si ta gjej? Ebu Hanifja i thotë : Për këtë nuk mund ta dijë , por po ta jap një propozim menjëherë pas namazit të jacisë ,zgjohu në mesnatë dhe falë namaz mesnate.

Menjëherë në namazin e sabahut vjen ai njeriu te Ebu Hanife e i thotë : O Imam e kam gjetur pasurinë: Ebu Hanifja i thotë:Po si e gjeje? Ai tregon :Kam vepruar ashtu siq më ke këshilluar dhe gjatë faljes së namazit të mesnatës , më është kujtuar .Ebu Hanife pastaj i thotë : Për Zotin ,e kam ditur se shejtani nuk të len me qenë i përkushtuar me lutje te Zoti yt,dhe do të vjen në mendjen tënde për me të tregu ku e ke pasurinë ,dhe ti të anosh ka shejtani dhe do të biesh në kurthin e tij, që për shkak të gjetjes së pasurisë mos me përfunduar namazin. Por a e përfundove, a jo?

KY ËSHTË KOMPENZIM(KEFARET) I YT

Thuhet se: Sëmundjet të cilat na kaplojnë janë për qëllim që pastrohemi prej mëkateve ne ditën e kijametit të jemi sa më të pastër .A është kjo e vërtetë?

Është pyetur i Dërguari i Allahit s.a.v.s . Çka është puna me sëmundjet që po na kaplojnë,çka kemi prej tyre ?

Është përgjigjja:,, Është kompensim i mëkateve Ebu Said el Hudriju i thotë: Edhe nëse është ndonjë sëmundje e lehtë ,apo sëmundje të lehta :Është përgjigj: Edhe nëse është një sëmundje sa aq e lehtë sa për të klithur e deri tek më të rëndat.

*E ka regjistruar
AHMEDI*

KOMPENZIMI (KEFARETI) I ATIJ QË KONTAKTON ME BASHKËSHORTEN GJATË MENSTRUACIONIT

Cili është kompensimi i atij, i cili kontakton seksualisht me bashkëshorten deri sa ajo është me menstruacion?

Përgjigjja: Kontakti seksual e dëmton mitrën ,e mund të shkaktoj edhe sterilitetin. Prej sëmundjeve më të rënda të femrës është kur të ndiej dhembje në mitër dhe rreth saj të cilat nuk mund ti përballoj,për shkak të temperaturës së lartë ,ndezjeve në organet gjenitale të cilat ndodhin për shkak të kontaktimit seksual gjatë menstruacionit.

Kjo sa i përket femrës,ndërsa sa i përket pasojave në vetë mashkullin janë këto:

Ndezjet e mëdha të cilat ndodhin në organin gjenital të cilat pastaj shoqërohen me mikrobe brenda kanalit të urinor, bile mund të shkojë deri te mashkulloret, ndezjet pastaj vazhdojnë në të gjitha pjesët rreth e përqark.

Ndërsa sa i përket kompensimit :Transmeton Ibn Abasi nga Pejgamberi s.a.v.s. se ka thënë: Ai i cili kontakton seksualisht me bashkëshorten deri sa ajo është me menstruacion le të jep sadaka një dinarë ose gjysmë dinari.

*MUTEFIKUN
ALJHI*

Hadithi tregon se është vaxhib kefareti (kompensimi) kush kontakton seksualisht me bashkëshorten e tij, deri sa ajo është me menstruacion

KAN REFUZUAR TË MARRIN PËRGJEGJËSINË ... A DO TË THOTË KJO MËKAT DHE KUNDËRSHTIM

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejt vetes, dhe ishte i padijshëm”.

(El-Ahzabë, 72)

A do të thotë: “Kanë refuzuar me marrë përgjegjësinë”, a do të thotë mëkat ,apo jo?

Përgjigje: Përderisa është e drejta e zgjedhjes që do të thotë ti ke mundësi me pranuar këtë ose mos me pranuar, pra ke mundësi me thënë: Unë veç i kam pranuar të hollat ,ose nuk i kam marrë,pra ky është emaneti, e drejta e zgjedhjes është alternative. Ti dhe emaneti yt mundeni me thënë të vërtetën ose mundeni mos me pranuar. Kur Zoti i

Lartmadhëruar ka thënë: Ne ia kemi paraqitur emanetin qiejve dhe tokës, edhe kodrave, dhe kanë refuzuar me marrë përgjegjësinë e sajë"Kjo do të thotë se të gjitha këto i kanë refuzuar që me pas të drejtë zgjedhjeje për atë çështje por e kanë preferuar që të jenë të nënshtruara ashtu siq dëshiron Allahu i Lartmadhëruar. Behet pyetja. Pse? Pse të gjithë i janë frikuar pasojave të asaj të drejte në zgjedhje, e cila mund ti shpie në mëkat ose do të vepronë në kundërshtim me urdhrin e Allahut. Mirëpo njeriu me mendjen e tij e ka pranuar këtë emanet. Ka pranuar që ai të ketë të drejtë zgjedhje. Imami i mirënjohur e thjeshtëson këtë çështje duke thënë: Të konsiderojmë se erdh te ti një njeri ,e ai ka një sasi të pasurisë dhe thotë:Unë dëshiroj që këtë pasuri ta lë tek ti emanet.ke të drejtë njëjërën prej dy çështjeve:Ose me vepruar siq kanë vepruar ato krijesa (qielli toka dhe kodrat)pra me refuzuar me pranuar atë emanet ,e me i thënë vetes tënde kjo është vështirë për mu,atëherë ai njeri atë pasuri do të ma lenë mua ,ai ndoshta largohet e unë i shpenzoj në çështje të mashrimit pas kësaj bote,e kur të vjen koha me ia kthyer unë nuk mundem t'ia kthej pasurinë .E për mos me ra në grackë unë atë që është e pasigurt nuk e pranoj por shkoj në atë që është më e sigurt ,dhe nuk e pranoj atë emanet, sepse ti po më propozon diçka që unë nuk mundem me bartë e më mashtron shejtani .Nga këtu ,unë nuk dëshiroj që ta sprovtoj veten time dhe nuk e marrë pasurinë si emanet.

Pra ,kur e ka marrë emanetin njeriu thelbësore ka qenë se ai ka pranuar lirinë për të vepruar ose për të mos me vepruar.

Për këtë arsye shpalljet qiellore i kanë zbritur njeriut sepse ai e ka pranuar emanetin që do të thotë e ka marrë të drejtën e zgjedhjes në duart e tij, për të vepruar atë për të cilën është i kënaqur Allahu dhe për tu largu nga ajo të cilën e urren Allahu, mashtrimin e shejtanit dhe dunjasë, dobësinë e tij njeriu nuk e ka llogaritur ,për këtë arsye ai është zullumqar dhe injorant ,pra zullumqar i vetes së tij sepse ai ka menduar dhe ka llogaritur më shumë se sa ka aftësinë e tij me bartë. Ky është ai mashtrimi i cili e shpie njeriun me dalë nga Imani. Mashtrimi, i cili e ka mashtruar Karunin kur i ka thënë “Vërtetë kam përfituar dituri vetë prej vetes sime" Pra njeriu mashtrohet me veten e tij, me mendjen e tij dhe me aftësinë e tij duke harru se ato aftësi janë prej Allahut dhe se Ai është i Cili ia ka dhënë atij , e në të njëjtën kohë Ai ka mundësi me ia marrë .Njeriu është injorant ,sepse atë e injoron atë çka ka rreth vetes së tij sepse Allahu i Lartmadhëruar ka mundësi ,Ai ka Forcë e Fuqi, Ai është Dhurues, Pengues Ngritës, Ultësues, Lartësues, Nënçmues. Dhe kështu njeriu e ka pranuar ta bartë amanetin, sepse Allahu i Lartmadhëruar ia ka lënë në kompetencë: vepro ose mos vepro. Dhe përderisa Zoti i Lartmadhëruar ka thënë njeriut vepro kështu kjo do të thotë se ai ka mundësi për të vepruar atë.

LEXUESI I FILXHANIT

Leximi i filxhanit është haram apo hallall?

-Ka mendime të ndryshme rreth leximit të filxhanit .Ka të tillë ,lexues te cilët ndërlidhen me ndërmjetësues të cilët paraqiten më këtë apo atë formë dhe japin gjëra apo parashikime të dyshimta ,dhe tregojnë për tregime të cilat nuk janë të sigurta e pastaj në bazë të atyre tregimeve mendojnë se do të ndodhe kështu apo ashtu.

Është e mundur po ashtu që lexuesi me pasur nën kontroll xhinin, i cili paraqitet në filxhan në cilën formë dëshiron ai dhe e sheh atë e flet me të. Ajo sheh në filxhan një njeri ,ose rrugë të hapur ose udhëtim me aeroplan ose me anije ,të gjitha këto janë mundësi të shejtanit sepse ai mund të paraqitet në cilën formë dëshiron ai.

Në shumicën e rasteve shohim lexues të filxhanit të cilët përfitojnë duke kërkuar shpërblim për leximin e filxhanit por duke mashtruar njerëzit .Mirëpo ka prej njerëzve

të cilëve Allahu u ka hapur rrugën atyre dhe ata dëgjojnë fjalët për të cilat kanë nevojë ata,por natyrisht ata nuk marrin shpërblim dhe nuk përfitojnë prej asaj veprimtarie ,sepse atë mundësi ua ka dhënë Allahu dhe ata nuk bazohen në mundësitë dhe aftësitë e tyre sepse këto mundësi dhe këto aftësi ua ka dhënë Allahu i Lartmadhëruar për me i nderu dhe me i fisnikëruar ata njerëz që ata me bë mirë ,kështu që kjo është një lloj „KERAMETI" por Allahu e di më së miri

BOTA E PADUKSHME

Çka është bota e padukshme dhe cili është kuptimi i ajetit Kur'anor „Njohës"(Mësues),të padukshëm dhe nuk ia tregon sekretin e tij askujt. A ka lloje të çështjeve të padukshme dhe a mundet që ndokush ti zbuloj ata sekrete me logjikën njerëzore ose ajo është sekret prej sekreteve të madhësisë së Allahut. Dëshirojmë mendim të plotë nga ju i nderuar ,pasi që kjo është prej çështjeve të rëndësishme me të cilën janë marrë dhe po merren shumica e muslimanëve, prej njerëzve të rëndomtë e deri te dijetarët më eminent.

I Nderuari u përgjigjur:

Të padukshme janë dy llojesh:

E padukshmja absolute dhe

E padukshmja relative

E padukshmja absolute është e padukshmja e (fshehtësia), të cilën nuk e di askush tjetër pos Allahut të Lartmadhëruar.

E padukshmja relative (mukajed) është e padukshmja (fshehtësia), të cilën disa e mësojnë apo me fjalë tjera u shpaloset e disave jo.

Të sjellim një shembull :Kur të përfundojnë provimet e studentëve në fund të vitit para se të shpalosen rezultatet atëherë këtu kemi të bëjmë për fshehtësinë (të panjohurën) për mua dhe për ty ,mirëpo është e njohur për profesorët dhe komisionin e provimeve. Edhe një shembull tjetër kur të vidhet diçka prej teje ,hajni është i panjohur sa i përket çështjes sate sepse ti nuk ke njohuri për te ndërsa sa i përket atij dhe atyre të cilët kanë qenë me të nuk është fshehtësi.

E kur ta mësojmë atë fshehtësi atëherë ka ekzistuar dikush tjetër (detektivi,policia) të cilët më kanë informuar dhe kanë pasur mundësi me ma bërë të njohur ,pra kjo nuk është fshehtësi . Disa njerëz kërkojnë informata prej xhinëve ,ai(xhin) merr përsipër me mbledh informata dhe me mi sjellë mua. Këto janë informata që disa kanë mundësi me i mësuar. Kështu pra është Mësuesi i fshehtësive Allahu i Lartmadhëruar ,ai e ka parapa se do ti tregoj në të ardhmen për ndonjë fshehtësi, të cilën nuk e di askush ,pra ky është Mësuesi i fshehtësive .Ndërsa bota e të padukshmes (të fshehtës) kjo kuptohet në vetvete se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Nuk ia shpalosë fshehtësinë e Tij askujt pos atyre me të cilët është i kënaqur prej të Dërguarve .Njerëzve të tillë ua shpalosë Allahu fshehtësinë e disa sendeve mirëpo ti ato nuk mundesh m'i ditur apo me marrë përgjigjur për çdo çështje që dëshiron ti,sepse Allahu ua ka shpalosur vetëm atyre që ka dashur Ai me i përgëzuar. Dhe ky njeri mund t'ia shpalosë atë lajmë të mirë ndokujt .Fshehtësia pa marrë parasysh a ka ndodhë në të kaluarën a do të ndodhë në të ardhmen ,kur të shpaloset ajo bëhet fshehtësi e së kaluarës pra e ka heq perden e së ardhmes. Ndërsa sa i përket të sotmes ,kjo do të thotë është heq perdja e e vendit e gjatësisë gjeografike që do të thotë informon apo paralajmëron personi për diçka çka ka ndodhë në Aleksandri e ai është ulur me mua këtu në Kairo në të njëjtën kohë.

Te Allahu i Lartmadhëruar ndodhitë janë një. Kur të na lajmëron për diçka për të ardhmen kjo është sikurse të ketë ndodhur sot, sepse nuk ka forcë a fuqi që me vepruar përpos ashtu siq ka thënë Patjetër duhet me ndodhë siç ka paralajmëruar Allahu se ka me ndodhë në të ardhmen, pra e ardhmja është realiteti i së kaluarës ,Zoti i Lartmadhëruar ka thënë : Ka ardhur urdhri i Allahut (ka ndodhë kijameti) e ju mos shpejtoni. Pra fjala „ka ardhur " është folje e kohës së kaluar ,ndërsa pjesa tjetër mos shpejtoni tregon se kjo është për të ardhmen .Pra kuptimi i kësaj se kjo çështje në të ardhmen pa kurrfarë dyshimi ka me ndodhë sepse nuk ka forcë tjetër e cila mundet me ndryshuar atë që e ka thënë Zoti i Lartmadhëruar çka ka thënë për të ardhmen ajo do të realizohet dhe sikurse veç me pas ndodhë.

Koha e kaluar është çështje e cila ka ndodhë për te njerëzit ,ndërsa e ardhmja është çështje e cila veç ka ndodhur për te Allahu i Lartmadhëruar. Për këtë arsye :Kur të thuash: Filani ma ka shpalosur një fshehtësi .Ne themi:Ajo çështje a ka qenë fshehtësi për ty dhe për të tjerët,apo vetëm për ty? Nëse ka qenë fshehtësi (e panjohur) për ty e jo fshehtësi për të tjerët sepse këtë çështje në këtë mënyrë apo në ndonjë mënyrë tjetër ke pasur mundësi me mësuar.

Nëse një ndodhi e botës më të lartë të cilën nuk e di askush ,dhe Zoti i Lartmadhëruar u jep mundësi që me ditur vetëm disa prej krijesave të Tij si dhuratë ,siq është rasti i lajmërimit të Zekirija a.s se do të ketë një djalë dhe emri i atij djali do të jetë Jahja.

Përfundojmë se fshehtësinë absolute (mutlak) nuk e di askush tjetër përveç Allahut,nuk themi se është bota e të padukshmes fshehtësi por themi se Mësuesi i të fshehtës .

Ne prej njerëzve marrim informata ,me fjalë tjera na shpaloset për të njohur të fshehtën>Kjo është gabim pse prej begative të Allahut është se i ka fsheh disa gjëra ose tregojnë një njeriu se do ti ndodhin njëqind raste të lumtura në jetën e tij dhe tregojnë vetëm një ndodhi të pikëlluar dhe shikoje atë ,do ta shohësh se lajmi pikëllues i tejkalon ,i peshon lajmet e mira ,dhe kjo ndodhi e rrëzon për toke para se të ndodhë ,sepse jeton jetë të izoluar. Allahu është i butë për ne dhe i mëshirshëm edhe në raste të fatkeqësisë (ditës se Kijametit)e ju pse po shpejtoni pse po brengoseni?

ËNDRRAT E VËRTETA

I nderuar Shejhi :Çka janë ëndrrat e vërteta dhe a janë specifike e pejgamberëve ,në lidhje me këtë,ajeti Kur'anor „Do ta tërheqim zvarrë për hundë"

Kur'an

i cili ajeti tregon për Velidin ,a jep të tregoj për ndodhi e cila do të ndodhë në të ardhmen.

Përgjigjja: Është e mundur ,ne mund ta parafytyrojmë se si një Dijetarë e sjell një shembull tipik për diçka ,ajo ngjarje ndodhë saktësisht siq e ka tregu dijetari më herët sh. inxhinieri i cili e bën projektin e një ndërtese e cila do të ndërtohet pastaj ndërmarrja (mjeshtrit) e ndërtojnë ashtu siq e ka përshkruar dhe siq e ka projektuar ,ashtu e ndërtojnë dhe ngjason në projekt,edhe me ngjyrat brenda dhomave,po ashtu ku do të vendosen orenditë e kështu me radhë. E gjithë kjo ndodhë me aftësinë dhe profesionalizmin e mjeshtërive dhe inxhinierit i cili e ka parapa me qenë salloni me një ngjyrë të caktuar mirëpo aftësia dhe mundësia e tij stopohet atëherë kur të bëhet punimi i asaj ndërtese kur ngjyra e kërkuar dhe e paraparë nuk gjendet në treg ,atëherë ngjyroset p.sh. apo me kombinimin e ngjyrave nuk mund të prodhohet ngjyra e kërkuar, atëherë ngjyroset me ngjyrë të përafërt ,mirëpo nuk është ngjyra e cila është paraparë .Kjo është ose si shkak i planifikimit të paraparë ,ose pamundësia e sigurimit të elementeve. Mirëpo si qëndron

puna me Atë te i cilit nuk mund të ndryshojë rrethanat ,dhe ka aftësi absolute. Kur të përcaktojë diçka patjetër duhet me ndodhë .Atëherë paraqitet dhuntia e Zotit pa me sjellë një shembull ,një pasqyrim të një ngjarje e cila do të ndodhë në të ardhmen. P.sh. me thënë: Në këtë vend do të ndërtohet shtëpia ime e cila do të ketë këto cilësi ,këtë formë,kaq dhoma e kështu me radhë. Kjo konsiderohet ,paralajmërim "Prej paralajmërimeve të të Dërguarit të Allahut janë ëndrrat e vërteta .Ka prej njerëzve të cilët shohin ëndërr në gjumë, mirëpo ka të tjerë të cilët e shohin ëndërrën zgjuar(parafytyrim).Ne shohim se Zoti i Lartmadhëruar i ka tregu Muhamedit a.s. për ndodhi më të kaluarën ,e dihet mirëfilli se Muhamedi a.s. nuk ka mësuar për atë ndodhi ,nuk ka qenë prezent në ato ndodhi dhe ata e kanë ditur se Muhamedi a.s. nuk i ka ditur ato. Po ashtu edhe Kur'ani e tregon këtë realitet dhe e vërteton kur thotë: Ti nuk ke qenë në Kodrën Turë" Nuk ke qenë në mesin e tyre kur ata kanë gjuajtur lapsat e tyre (për short) se cili prej tyre do ta ketë nderin me marrë në përkujdesje Mejremën, e as nuk ke qenë në mesin e tyre kur kanë ra në mosmarrëveshje(konflikt) mes vete". Dhe nuk ke qenë te populli Medjen duke ua lexuar atyre ajetet tona" Të gjitha këto janë njohuri të mrekullisë mbinatyrore për ngjarjet që kanë ndodhë në të kaluarën. Ne luftën e Muetes kur Muhamedi a.s. i ka marrë pozitat në të njëjtën kohë kanë ndodhë paralajmërimet dhe në të njëjtën kohë është zhveshë perdja kohore.

Kur Muhamedi a.s. ka bërë përgatitjet e betejës e ka shkelë me këmbë vendin dhe ka thënë ;Këtu është vendvrasja e filanit, këtu është vendvrasja e filanit, e pas kësaj në të ardhmen ndodh e njëjta gjë dhe vërtetohet ajo çka ka thënë. Çka është ajo çka e përcakton fushëbetëjen ,lëvizjen e luftëtarëve të tjerë e Muhamedi a.s. e di saktësisht se ku do të ndodhë filani. Si është e mundur kjo?E për Velidin ka thënë,,Do ta tërheqim zvarrë për hundë"e ka përcaktuar fushëbetëjen dhe vendin e plagës vdekjeprurëse. Kush është ai i cili e përcakton fushëbetëjen dhe vendluftimin e personave ku kanë me ra saktësisht ,në cilin vend do te vriten .Kjo është mrekulli mbinatyrore për të ardhmen e lajm i cili e di te ardhmen ,dhe nuk ka asgjë që mund ti ikë dëshirës së tij. Pra kjo është specifikë në të cilën është dalluar Muhamedi a.s. për tu ngritur personaliteti i tij.

XHENETI NËN KËMBËT E NËNAVE TUAJA

Imam i nderuar cili është kuptimi "xheneti është nën këmbët e nënave "

Përgjigjja: Thuhet :Filani pran duarve të filanit,që d.m.th. para tij

Thuhet: „Nën këmbët e filanit" .Kjo alegori si p.sh.: Kur thua: Filani ma dha dorën ,pra filani ta ka dhënë dorën edhe pse as që e ke prekur dorën e tij. Kjo i përngjan sikurse me ia pas marrë dorën e tijë dhe me e sjellë në cilin drejtim dëshiron ,dhe vepron me dëshirën e tij edhe pse nuk e ke prekur dëshirën e tij.Kjo don të thotë : Ai është urdhër dhënës ,i cili nuk del jashtë kornizave të dëshirës së tijë ,ashtu siq nuk del dora e tij, të cilën e ke në dorën tënde. Dhe kur themi :Vërtetë xheneti është nën këmbët e nënave tuaja. Kjo nuk është lajmërim për vendin e xhenetit por kuptimi i kësaj është :Kush dëshiron xhenetin le të qëndrojë më afër këmbëve të nënës tij,që do të thotë me qëndruar në vendin ku njerëzit mendojnë se është poshtërsi.

Për këtë arsye kuptimi „Xheneti nën këmbët e nënave " është:O ti i cili e dëshiron xhenetin përulju dhe nënshtroju ashtu siq ka thënë Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an :Dhe shtrijë këmbët e përulshmërisë së mëshirës"

Kur ka këshilluar Muhamedi a.s. ka këshilluar më shumë me u përkujdesur për nënën se për babën ,për arsye se baba ka mundësi më të shumta për të siguruar ekzistencën. dhe ai më pak ka nevojë ose nuk mund të ketë fare ,sepse edhe nëse paraqitet nevoja dhe bëhet

lypës ai e ka më lehtë,ndërsa nëna arrin në atë gjendje, pra me pasur nevojë më lypë është poshtërim për ta, duhet që kurrë mos me ardhur në atë gjendje me ardhur në atë gjendje dhe me e largu nga ajo gjendje.

Kur është pyetur Muhamedi a.s. kush ka më së shumti përparësi për shoqërim ka thënë :Nëna jote, nëna jote, nëna jote e pastaj babi yt. Pra ka porositë tri herë për nënën para se të porositë për babën .Sepse nëna përfaqëson anën e të dobëtëve ,ajo përfaqëson ledhatime ndjeshmëri .E Allahu ka dashur ta siguroj atë.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë : “Zoti im mëshiroj ata dy siq janë sjellë me mëshirë ndaj meje kur unë isha i vogël" a kërkuar nga fëmija që me e lutur të Lartit dhe të Gjithëfuqishmit për të dy prindërit ,që ndaj tyre Allahu me qenë i mëshirshëm ,pastaj ka tregu se edukimi dhe përkujdesja ka qenë prej të dyve edhe prej nënës edhe prej babës .Nëna është ajo e cila e përkëdhel dhe përkujdeset ndërsa baba është ai i cili sjell furnizim ushqime veshmbathje ,mirëpo në esencë që të dy janë bashkëpjesëmarrës në edukim dhe përkujdesje. Zoti Lartmadhëruar gjithashtu ka porositë për mirësi,,Dhe ne e kemi porositur njeriun për mirësi ndaj prindërve"Pra ka porositë mirësi për të dy prindërit ,ndërsa në ajetin tjetër,,Dhe thuaj O Zoti im mëshiroj ata dy siq kanë qenë të mëshirshëm dhe janë sjellë mirë me mua në vegjëli. Pra Zoti i Lartmadhëruar ka porositur për të dy prindërit. Ndërsa në ajetin tjetër shohim:Ne e kemi porositur njeriun për mirësi ndaj prindërve ,e ka bartur nëna e tij me vështirësi dhe mund të madh dhe e ka lindur me vështirësi dhe mund të madh. Ne ajetin tjetër:E ka bartur nëna e tij vështirësi përmbi vështirësi "Në të dy ajetet fisnike ka tregu shkaqet pse ka porositur për nënën. Sepse çështje, të cilat i vepron baba për të birin janë çështje të qarta dhe të njohura .Atëherë kur fëmija fillon të kuptoj e sheh se çdo gjë e ka burimin prej babës së tij, ai sjell pasuri me të cilat blen gjërat e nevojshme për këtë arsye ai fillon me kuptuar se të gjitha shpenzimet janë prej babës. Fëmijës nuk ka nevojë me ja tërheq vërejtjen për këto çështje se ai i sheh vet, sepse me pjekurinë e tij e kupton se çka bën baba për te. Ndërsa sa i përket mendimeve të nënës, për fëmijën ato mendime kanë ndodhur atëherë kur ai nuk ka qenë i moshës së rritur ,kur ka filluar të kuptoj ajo fazë veç ka kaluar. Ai nuk mundet ti kuptoj mendimet të cilat i ka përjetuar nëna gjatë kohës së shtatzënisë, gjidhënies dhe lodhjen e tepërt duke u përkujdesur për te kur ka qenë ai foshnje .Për këtë arsye mendimet e nënës të cilat nuk i ka parë i drejtohet Zoti i Lartmadhëruar me këshilla. Mirëpo këshillimi vjen atëherë kur ai të rritet kur të jetë i aftë për me kuptuar se çka vepronjë prindërit e tij momentalisht ,mirëpo çka ka vepruar nëna e tij në të kaluarën ai nuk mundet me e kuptuar vetvetiu por mundet me e kuptuar atëherë kur t'ia shpjegon tjetri .E për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar ia përkujton atë kohë dhe e këshillon.

DHURIMI I GJAKUT

Cili është shpërblimi i dhurimit të gjakut dhe a ka të drejtë dhuruesi të merr fitim prej dhurimit, dhe nëse merr kompensim a zhvishet prej shpërblimit të dhurimit të gjakut. A mund të na sqaroni këtë Imam i nderuar.

Imami ynë i nderuar Shejh Shearëviju u përgjigj:

Vetëm dhurimi i gjakut pa marrë parasysh a merr kompensim a jo ka shpërblim sepse një gjë e tillë shpëton jetën e një njeriu posaçërisht pasi që medicina bashkëkohore ka mundësi ta bëjë rezervimin e gjakut .Përderisa sasia e dhurimit të gjakut nuk dëmton dhe nuk e dobëson shëndetin e dhuruesit .Argument për këtë është se njeriu aksidentalisht mund të rrjedhë shumë gjak,e ajo sasi është më e madhe se sa dhuron ,mirëpo kur ti ndalet gjakderdhja dhe i mbyllet plaga ,humbja e gjakut nuk kanos rrezik të jetës së tij

(sasia e vogël),dhe nuk dëmton shëndetin e tij nëse veç ka qenë i shëndoshë .Mirëpo përpos kësaj gjaku i ripërtërihet, dhe gjaku i humbur i plotësohet. Për këtë arsye përderisa ai gjak i humbur nuk ndikon ne shëndetin e tij negativisht ,dhe ajo nën kontroll të mjekut. Dhurimi i gjakut edhe me të holla për te ka shpërblim. Por nëse dhuruesi i gjakut nuk dëshiron të holla (kompensim) ai ka dy shpërblime: shpërblimin e dhurimit të gjakut dhe shpërblimin (prej të cilit ka hequr dorë) me të holla. Allahu e di më së miri.

LINDJA E VËSHIRË FSHINË MËKATET

A është e vërtetë se çdo grua e cila lind fëmijë i falen mëkatet në tërësi. Gruaja e cila lind fëmijë me vështirësi të madhe ,dhembje të madhe pra më shumë se lindja në gjendje të zakonshme ,por ajo duron ,beson dhe shpreson në shpërblimin e Zotit për atë gjendje të vështirë i fshihen mëkatet.

HAXHI PREJ LLOGARIVE BANKARE

A lejohet me u kryer haxhi prej kamatës bankare apo një gjë e tillë është në kundërshtim me ligjin e Allahut.

Na urdhëro dhe na sqaro ,për këtë Zoti ju shpërbleftë

-Haxhi prej kamatës është haram,haram,haram. Haxhi patjetër duhet me qenë prej pasurisë hallall ,mëkatari nuk mund ti afrohet Allahut me mëkat. Poeti ka thënë

Nëse shkon ne haxh me pasurinë e përlyer

Nuk ke kryer haxhin, por deveja ka shkuar haxh.

TË JETUARIT ME VRASËSIN

Burri im ka vra një njeri gabimisht, bashkëjetesa me të a është haram apo hallall. Kjo çështje më ka munduar ditë e natë dhe mendja asnjëhere nuk ka pushuar e zemra asnjëherë nuk më është qetësuar. A mundet që i nderuari ynë Shaëraviju të ma lehtësojë gjoksintim dhe të më çlirojë mendjen time e cila më preokupon? Zoti e shpërbleftë

Përgjigjja: Të jesh e lirë se deri sa burri yt nuk e ka vra me qëllim por gabimisht ai duhet të kompensojë vrasjen gabimisht ashtu siq e ka parapa Allahu, ndërsa bashkëshortja nuk ka kurrfarë pengese me jetuar me të, nuk ka kurrfarë lidhje bashkëjetesa burrë-grua dhe atë që e ka vepruar burri.

ABDESI FAZA E PARË E ADHURIMIT

Abdesi është hyrje në fazën e parë të adhurimit të parë ,e ai është namazi. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të na përgatitë neve shpirtërisht ,na ka urdhëruar me marrë abdesë. Pse ka thënë ,kur ka thënë :Dhe kur të vendosni me falë namaz,pastroni fytyrat tuaja ,dhe duart tuaja deri në bërryla" Kjo do të thotë se urdhri përfshin pastrimin e duarve deri në bërryla. Pra urdhër është që të bëhet pastrimi i fytyrave dhe duarve deri në bërryla" Në rend të parë është pastrimi i fytyrës pastaj pastrimi i duarve. Sa i përket fytyrës nuk është përcaktuar asgjë,pra,,fytyrat tuaja" ndërsa te duart është përkufizuar ,,deri në bërryla".Sikur Allahu dëshiron pastrimin e kufizuar ,ndërsa fytyra nuk sjell ndonjë marrëveshje ,sepse fjala fytyrë është e njohur gjithësisht se cilën hapësirë e përfshin ne vete. Ndërsa sa i përket fjalës ,,dorë" ka mendime të ndryshme të përkufizimit të hapësirës së sajë. Allahu dëshiron mos me shkaktuar mosmarrëveshje ,për këtë arsye e

ka definuar „deri në bërryla" .Po mos të kishte qenë definuar „duart tuaja deri në bërryla" Disa do të kishin thënë duart me i pastruar vetëm shuplakat,tjerët deri në bërryla tjerët tërë dorën pra me gjithë krahët. Dhe secili kishte me thënë e mundur është edhe ashtu. Mirëpo Allahu ka dëshiruar me përkufizuar deri në bërryla dhe nuk ka më alternativë tjetër. Pas kësaj Zoti i Lartmadhëruar ka thënë :„Lëmoni kokat e juaja " ashtu siq ka thënë „pastroni fytyrat tuaja" dhe pse nuk e ka definuar hapësirën e lëmimit të kokës .Pra vet kjo formë e tekstit tregon mundësin e alternativave të cilat Zoti i Lartmadhëruar i pranon .Parafjala „B" në këtë fjalë është parafjalë mbështetëse.

JU I DINI MË SË MIRI ÇËSHTJET E JETËS SUAJ

I nderuari Imam! Nëpër tribuna, nëpër vende të ndryshme ka dalë në sipërfaqe një pyetje serioze dhe e rëndësishme, e ajo është çështja e ixhtihadit në Islam. Secili e tregon në bazë të mendimit të tij, i dituri e injoranti, i specializuar dhe i paspecializuar, profesori e studenti, e ajo është çështja e rëndësishme me të cilën janë marrë shumica e mendimtarëve dhe dijetarëve dhe dijetareve të kohës së kaluar dhe të tashmes. Cili është mendimi i juaj në lidhje me këtë çështje shumë të rëndësishme?

Imami filloi sqarimin kështu:

Tek ne kemi njerëz që aq shumë janë liruar në fe sa që çdo çështje të fesë ia lënë ixhtihadit, ndërsa të tjerët çdo çështje të fesë dhe të dunjasë ia lënë ixhtihadit.

Ne u themi atyre: Që të dy palët e keni gabim, sepse ixhtihad do të thotë të angazhohesh, të shpenzohesh në maksimum për të dhënë mendimin, e kjo nuk do të thotë se duhet të hulumtohet, por gjërat ekzakte dhe qëllimi i njeriut asnjëherë nuk prish diçka nëse jep një mendim për çështjet të cilat janë të lejuara sipas ixhtihadit, ndërsa sa i përket të parës, shkencave ekzakte po. I pari i cili dëmton është ai i cili thotë jo, sepse unë e marr përsipër përgjegjësinë. Çështja tjetër është se ka prej njerëzve të gjitha çështjet e fesë ia nënshtrojnë parimit “Ju më së miri i dini çështjet e jetës suaj”. Që do të thotë çdo çështje dëshirojnë ta përfshinë në këtë hadith. Ne duhet ta kuptojmë burimin dhe esencën e hadithit. Hadithi është thënë për një çështje shkencore praktike, ndërsa çështjet praktike nuk duhet shikuar në mënyrë parazite vetëm prej qiellit, por duhet shikuar shkaqet e krijimit të materies, sepse Allahu ka garantuar dhe e ka vendosur ligj që në ato çështje nuk ka vend emocioni. Në çështjet e materies lëndore nuk mund të ndryshojë emocioni i dijetarit, por ndryshon aty ku është fakti, realiteti dhe praktika.

Çka është fakti, realiteti dhe praktika? Është ajo në të cilën përputhen elementet. Çështjet praktike dhe reflekset nuk mund të ndërhyjnë asnjëherë në emocione. E, kjo nga shkaku se Allahu ka garantuar që në çështjet praktike dhe ekzakte nuk ka vend ilozioni dhe emocioni. Mirëpo në çështjet ideore mund të ndërhyjë emocioni, por edhe kjo është dy lojesh. Lloji i parë në të cilin nuk kemi ndërhyrje në brendi dhe nuk lejohet ixhtihadi në të dhe lloji i dytë nga shkaku që të keni liri të hulumtimit dhe që të mos jeni të ngurtë në pranimin e obligimeve, por që të keni liri të veprimit dhe liri të zgjedhjes. Sa i përket çështjeve në të cilat veprimi zgjidhet do të thotë ka alternativë, ndërsa te çështjet lëndore praktike nuk ka kurrfarë alternative, sepse në to nuk ka vend për emocione dhe dëshira.

Them: Ne çdo herë vërejmë se janë dy pakte. Pakti lindor i Varshavës të cilin e kryeson Rusia dhe pakti perëndimor i Natos. Këta dy pakte janë në kundërshtim të njëri-tjetrit vetëm nga aspekti teorik, ndërsa nga aspekti i lëndëve jo, pasi nuk ka rrymë elektrike ruse dhe rrymë elektrike amerikane. Jo, kështu kurrë nuk do të ketë. Por pakti i Ruisë dëshiron që të përvjedh nga shkencat praktike, po ashtu edhe tjetri. Mirëpo në çështjet teorike shohim fortifikatë të hekurt i cili e pengon atë. Këto i pengojnë të tjerët

dhe të tjerët i pengojnë këta, ndërsa këto vjedhin prej të tjerëve dhe anasjelltas. Kjo vërteton se çështjet praktike lëndore nuk ka dëshira, por ashtu i pranojnë ashtu si i ka krijuar Allahu për njeriun. Allahu i ka krijuar lëndët në mundësi të njeriut dhe për njeriun. Dhe njeriu prodhon në bazë të zhvillimit dhe të çështjeve praktike. Ndërsa sa i përket asaj se ky është ateist, ky komunist, ky pabesimtar, në këto çështje nuk mund të ndërhyjë njeriu.

Vjen një njeri dhe të tregon: Pejgamberi i juaj Muhamedi ka thënë: “Ju jeni më vizionarët në çështjet e jetës suaj, ato janë çështjet praktike në të cilat ke liri të plotë e me këtë islami ka vendosur parimin shkencor praktik. Mirëpo në çështjet teorike në të cilat ndryshojnë dëshirat dhe emocionet kemi dy forma. *Forma e parë*: Forma e ligjeve absolute të pandryshueshme që do të thotë nëse në ato çështje konfrontohemi do të depresionohemi dhe do të lidhemi. Dhe *forma e dytë*: Nëse japim mendime të ndryshme nuk do të lodhemi, por edhe pse lodhemi lodhemi për shkak të fanatizmit, por dihet fanatizmi është cilësi vetëm e të dobëtëve. Pra kjo do të thotë se i pranuar apo nuk i pranuar çështjet e islamit, prapë se prapë i kemi pranuar, sepse iu jemi dorëzuar pa e hetuar.

Unë nuk i dorëzohem atij i cili është i nivelit tim, por i dorëzohem atij i cili është më i mirë se unë dhe më i ditur se unë . E kjo nënkupton islamin. Islami im është se unë e pranoj atë, se ajo është i Zotit të Vërtetë dhe të Madhëruar. Çdo veprim imi është i vërtetë, pasi është burim prej Allahut dhe prej të Dërguarit të Allahut dhe këtu përfundon çështja.

Analizo dhe shiko precizitetin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.; analizo fuqinë dhe guximin e bindjes së thellë të Pejgamberit s.a.v.s. kur ka thënë: “Edhe nëse nuk i mbarsni prapë do të ketë hurma, mirëpo ato pasi që nuk kanë bërë mbarsin e hurmave, hurmat nuk kanë sjell fruta. Shiko pra se çfarë stërvitje praktike ka bërë Muhamedi s.a.v.s. sa që ka thënë në çështjet shkencore praktike mos e dëgjoni as fjalën e Muhamedit birit të Abdullahut. A ka diçka të thuhet më shumë se kjo?! Mirëpo në çështjet e dëshirave dhe emocioneve shohim se në praktikë na ka thënë Allahu që praktika ta përkrahë dhe ta vulosë. Po si kjo? Shiko në çështjet teorike në të cilat ka pasur mospajtime, pastaj shiko edhe çështjet lëndore. Krahaso, pastaj do të shohësh se zbuluesi i çështjeve lëndore është shkencëtari i cili ka vërtetuar në praktikë e pastj njerëzit kurrë nuk e kanë kundërshtuar, por ai ka mbetur i vetmi zbulues i asaj çështjeje. Mirëpo askush nuk e di se sa ka sakrifikuar në punë, në kohë , ushqim e pije derisa ka arritur atë zbulim. Njerëzit e tjerë nuk kanë ndier asgjë derisa ka arritur te zbulimi, e ka vërtetuar atë zbulim apo çështje të re, e pastaj ne fillojmë ta shijojmë dobinë e atij zbulimi shkencor praktik. Mirëpo kush është ai i cili e ka nxjerrë në shesh atë zbulim? Vetëm ai dhe puna e tij. Por sa i përket teorive, teoricieni kënaqet ndërsa të tjerët lodhen derisa më në fund zbulohet se teoria e tij kishte qenë e dëmshme ose ndodh që vjen një teoricien tjetër dhe ia mposhtë teorinë e tij. Pra Allahu na ka shkarkuar barrën e cila na ka munduar. Është e vërtetë se edhe zbulimet shkencore lëndore e praktike janë të fshehta dhe të mbuluara deri sa Allahu kur të dëshirojë na mundëson që të arrijmë deri te ai zbulim. Mirëpo Allahu ka dashur ashtu, pasi Allahu është Krijues, projektues dhe ekzekutues. Dhe asnjë prodhues nuk dëshiron që t’i dështojë prodhimtaria e tij. Çdo prodhues e do prodhimin e tij; Allahu e do prodhimin (krijimtarinë) e Tij. Për këtë arsye nuk na ka lejuar çështjet e emocioneve dhe dëshirave, por e ka lejuar ixhtihadin, ndërsa ixhtihad domethënë se *kjo është e lejuar, por edhe kjo është e lejuar, por Allahu e di më së miri.*

PËR TË TRIUMFUAR (ME U PARAQITË) MBI TË GJITHA FETË

Pyetje :

Zoti i Lartmadhëruar thotë: „Ai (Allahu) është i cili ka dërguar të Dërguarin e Tij për të udhëzuar dhe fenë e vërtetë për me triumfuat mbi të gjitha fetë". Ne sot ende po shohim se ka ateizëm dhe fe të trilluara dhe nuk ka fe triumfale ndaj feve tjera?

Përgjigjja: Nëse e kuptojmë Kur'anin me logjikën Kur'anore dhe gjuhën arabe ,nuk do ta kishim parashtruar një pyetje të tillë .Sepse në ajet thuhet „për me triumfuat mbi të gjitha fetë ,edhe pse këtë e urrejnë pabesimtarët ,në ajetin tjetër ,edhe pse këtë e urrejnë idhujtarët", pra është fjala edhe do të triumfojë por edhe do të ketë urrejtës..Mirëpo ,po të mos ketë urrejtës prej pabesimtarëve dhe urrejtës prej idhujtarëve dhe të gjithë me qenë vetëm besimtarë atëherë çfarë kuptimi do të kishte „cilit me iu paraqit " atëherë?

Ia ka paraqitur kuptimin, ka triumfuat do të thotë se kanë qenë dy palë dhe njëri është fitues dhe tjetri humbës,e ata jan në mes të arenës ,epo të ishte vetëm Imani në njërën anë atëherë nuk ka arenë dhe nuk ekziston dueli dypalësh -pra dueli mes palëve.

Ja tani do të udhëzoheni duke shikuar gjendjen momentale, në bazë të përvojës në shoqëritë tuaja, në disa çështje ,dhe dëshironi ti zgjidhni sipas metodologjisë njerëzore ,ndërsa zgjedhja njerëzore është ne Islam,dhe zgjedhjet e problemeve përputhen me Islamin sepse ju vet e keni dashur me dale në arenë ,pastaj ju vetë keni qenë të detyruar edhe pse keni vazhduar qëndrimin në vendbanimet e juaja ,dhe keni vazhduar idhujtarinë e tuaj,për me pranuar të vërtetën por a e keni pranuar se është Islame apo pse e keni pa të vetmen zgjidhje ashtu siq e ka parapa Islami. Atëherë ,pjesa e ajetit „për me triumfuat mbi të gjitha fetë (sistemet,ideologjitë) do të thotë se di të do të dëshmojnë nëpërmjet ngjarjeve dhe eksperiencës se çështjet Islame janë superiore dhe se njerëzit do të jen të detyruar për ti pranuar, përkundër dëshirës së tyre ,edhe pse i urrejnë ,ata do të veprojnë me ato ligje,jo nga aspekti se janë Islame p.sh. sikurse është rasti me ata të cilët kanë kundërshtuar lejimin e shkurorëzimit ,e pastaj prapë jan detyruar ta marrin një hap të tillë ,pra duke e lejuar atë njësoj është edhe çështjet tjera si lejimi i kamatës ,lejimi i alkoolit etj. Analizojeni sa mjete ka shpenzuar Amerika në luftimin e këtyre çështjeve ,ata nuk e bëjnë këtë pse është Islame ,pra pse e ka ndalu Islami ,por e bëjnë një gjë të tillë pse i lehtëson apo i zgjedh problemet e tyre shoqërore,pra pjesa e ajetit „për me triumfuat mbi të gjitha fetë" ka kuptimin e ligjet e tij do të triumfojnë mbi ligjet e pabesimtarëve dhe do të angazhohet dhe do të mundohet me vepruar me të më shumë se me pasur qenë besimtarë, sepse ata nuk e bëjnë fetarisht dhe për shkak se janë këshilla fetare,por e bëjnë sepse ai veprim i qetëson dhe shpëton. Atëherë Islamin duhet ta pranojmë se është themel i dispozitave ose çdo çështje që e veprojmë që i përmbahemi iu kemi përmbajtur se ne iu kemi dorëzuar Allahut dhe çështjet i takojnë vetëm Allahut.

FEJA DHE SHKENCA

A bën dallim Islami mes fesë dhe shkencës, çka mendoni ju për këtë çështje, e cila ne kohë të fundit për te po flitet shumë.

Nuk ka dallim mes fesë dhe shkencës por përfshirja e diturisë në planprogramin e fesë ,sepse askush prej njerëzve të fesë nuk thotë: Ai i cili mëson kiminë është pabesimtarë. Ne themi „Feja dhe jeta"

Fjala fe i ka frikësuar ata që mendojnë për këtë botë e jo për fenë dhe fjala „botë" ka

frikësuar fetarë prej kësaj bote. Ne u themi atyre „nuk ka „fe dhe jeta“ .Kjo botë është përball botës tjetër ndërsa feja përfshinë që të dyja. Për ata të cilët kujdesen për këtë botë ,atyre disa u thonë:ata janë pabesimtarë ,ndërsa ,për ata të cilët kujdesen për botën tjetër disa u thonë të prapambetur. Ne u themi kjo nuk është e drejtë ,sepse përball botës tjetër është kjo botë dhe feja i përfshinë që të dyja ,sepse bota tjetër nuk është tematikë apo çështje e fesë së botës tjetër por është shpërblim dhe dënim.

SHPIFJA NDAJ ISLAMIT

Në librin EARLY MANKIND IN THE WORLD të historianit të njohur dhe arkeologut J.Henry Breasted, i cili është dijetar me famë dhe është studios i njohur kur ka qenë në pyetje Islami dhe përhapja e tij e kam pa se ka shkruar :Islami është përhapur me ehë të shpatës. Kur e kam lexuar këtë tekst jam brengosur shumë. Këtë thënie, e cila dëshiron t'ia mveshin Islamit orientalistët dhe të ngjashmit nga shkaku se e urrejnë dhe kanë xhelozitë ndaj Islamit. Sepse për një kohë shumë të shkurtër që nëse të njëjtën kohë e krahasojmë me popujt tjerë islami është përhapur prej Indie deri në Andaluzi që do të thotë i ka tejkaluar kufijtë kontinental të tokës .Dhe kjo bie me dyshuar se si mundet ashtu aq shpejtë me egërsi dhe me shpatë me u përhapë Islami!?

Për këtë çështje Shejh Sheëraviu thotë:

Islami është përhapur me mësim e të dobëtëve ,dhe nuk është përhapur prej të fortëve. Për këtë arsye kur ndokush prej tyre thotë:Islami është përhapur me shpatë,ne i themi atij:„Kjo është e papranueshme .Pasi që po thoni Islami është përhapur me shpatë kush e ka pas në dorë shpatën apo kush e ka shtyrë me kapë shpatën.

Kjo do të kishte qenë në rregull sikur Muhamedi .a.s. të kishte ardhur pejgamber me shpatë dhe do të kishte detyruar njerëzit me besuar mirëpo ata të cilët i kanë besuar mu ata kanë qenë të dobët ,ne nuk po flasim për shpatën e cila është marrë por për atë i cili ka qenë bartës i shpatës në rend të parë.

Edhe nëse pranohet (pretendohet) se Islami është përhapur me shpatë kush e ka mbajtur shpatën. Çështja është:Çka i ka shty ata të dobëtët me u bë të fortë dhe me mbajtur atë shpatë apo armë në dorë? Duhet të shikohet çështja e parimit pse Islami ka ardhur me paraqit rregulla dhe parime e jo për me mbajtur shpatën mbi kokë.

DALLIMI N'MES DITURISË DHE EDUKATËS

Cili është dallimi në mes të diturisë dhe edukatës?

Imami i nderuar Shaëraviu thotë:

Dituri do të thotë të depërtuarit r diturisë prej dijetarit në mendjen e nxënësit ,ndërsa edukatë do të thotë me marrë në përgjegjësi njeriu sjelljet e tij në atë çka e ka mësuar. Kjo për arsye se dituria fetare kërkon sjellje për atë çka e ka mësuar njeriu ndërsa kimia nuk kërkon me ndryshuar sjelljen me formulat e saj. Feja është sistem i aktivitetit tënd dhe nuk është vetëm çështje e lëvizjeve të trupave ,mirëpo aty ka çështje, të cilat nuk dëshiron që t'i ti veprosh ,mirëpo kërkon prej teje me vepruar,dhe çështje të cilat ti i dëshiron mirëpo kërkohet prej teje mos me i vepruar.

Pyetje:Po ,atëherë pse feja përkufizohet vetëm me medrese mesxhide dhe universitete dhe përmbajtja e fesë është bë shumë e vështirë?

Përgjigjja: Kjo nga shkaku siq thamë më parë fillon prej të mësuarit ,i mësuarit duhet të ketë mostër të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe shëmbëlltyrë me karakter Islam ne aspekte të përgjithshëm ,ose le të zgjedhin tjetër profesion. Duhet që sjelljet e tyre ti

harmonizojnë me atë ,me çka është ballafaquar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. që pastaj ata me e pasuar nxënësit e tyre .Muhamedi a.s. ka përjetuar çka ka përjetuar, mirëpo asnjë prej dijetarëve Islam nuk ka përjetuar vështirësi, të cilat i ka përjetuar Muhamedi a.s. .Pra mostra e kopjimi i saj jan bazament i suksesit ne procesin e mësimi fetar.

IDHUJTARIA E HAPUR

Në revistën Islame „DHAIATU SAJT" ,njeri prej komentatorëve të kësaj reviste e ka shkruar një artikull dhe në fund e ka shkruar këtë dua:

O Zot im,bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit.

Më vjen shumë keq për këtë ,Ius Allahun të na udhëzojë të na harmonizojë veprat tona dhe përfundimi ynë të jetë i mirë.

Shejh Shaëraviju thot: Të gjitha cilësitë dhe emrat e Allahut janë edhe krijesa. Në shikojmë vetëm atë masë të cilën Allahu i ka përshkruar cilësitë e tij, ndërsa realitetin e vërtetë të atyre cilësive nuk është e domosdoshme me e ditë .

Allahu ka thënë: “Unë dëgjoj” “Unë shikoj” Pra ai ka të dëgjuarit të shikuarit .Mirëpo mos e merr ti formën e dëgjimit dhe të shikimit të cilët ti e njeh në krijesa. Vërtet dëgjimi dhe shikimi i Allahut është si te ne. Parashtrohet pyetja: Pse?

Sepse ti gjykon me logjikën tënde Zoti ekziston e po ashtu edhe krijesat ekzistojnë ...mirëpo a është krijesa si krijuesi. JO! Pasi që Krijuesi nuk është si krijesa ,pse atëherë shikimin dhe dëgjimin i Krijuesit t'i bënë si shikimin dhe dëgjimin e krijesës .Në esencë ti ndryshon se je krijesë e Ai Krijues. Allahu është i Gjallë ,njeri është i gjallë pasi flet,mirëpo Jeta e Allahut a është si jeta ime. JO! Kur thuhet një emër apo një cilësi e Zotit e njëjta cilësi të njeriu atëherë ti je para dy çështjeve: Atë mos me përshkruar si të njeriut por as mos me e mohu,pra nëse dikush thotë:Nuk ka të dëgjuar sepse dëgjimi është cilësi e njeriut ,Ne themi i themi se :Ti po bënë krahasim të gabuar sepse ne shohim aparatit e të dëgjuarit e ti veç e ke me pastruar nga kjo. E vërtet, ti dëshiron me e pastruar Allahun ,mirëpo ti pse tekstin Kur'anor po e hedh poshtë

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: „Unë dëgjoj"Ndërsa ti po thua ai posedon të dëgjuar ,mirëpo forma e të dëgjuarit nuk është çështje e imja. Sepse Mënyra se si gjithmonë është çështje e besimit -IMANIT.

VENDET KU NUK PËRMENDET EMRI I ALLAHUT

A ka vende ku nuk lejohet të përmendet emri i Allahut dhe nëse ka cilat janë ato?

Përgjigjja: Po! prej këtyre vendeve janë WC dhe banjot në momentet kur kryhet nevoja. Kjo për arsye të pastrimit të emrit të Allahut të Lartmadhëruar nga këto vende të fëlliqura. Ka edhe vende tjera ku besimtari nuk është mirë me e përmend emrin e Allahut. Në vendet apo më mirë në momentet kur dikush vjen e kërkon diçka prej teje, e ti nuk ke me i dhënë, ndërsa ne e kemi bënë traditë me thanë „Zoti të dhashtë" dhe që në çastin kur i thua „Zoti " ai e kupton se ti nuk je duke i dhënë e ai e urren këtë fjalë , këtë arsyetim ku ti e përmend Allahun, sepse lypsi e urren atë që ti nuk je duke i dhënë diçka. Nëse ndonjë nënë e ka humb(i ka vdekur) birin e sajë të vetëm,ndërsa ne shkojmë me ngushëlluar nuk është e drejtë me i thënë asaj ashtu siq i thonë shumica e të paditurve:„Allahu është Ai i cili e ka bënë këtë ,ne nuk mundemi me bënë asgjë. Por e drejtë është me thënë „Caktim"pra vetëm caktim. Po bëhet pyetje pse? Sepse: Që në çastin kur i thua Allah ai mund të jetë i hidhëruar në Allahun.

Pra besimtari duhet me qenë vizionar ,ai mundet me ditë dhe me përcaktuar kohën

atëherë kur ta përmend Allahun. Emri i Allahut me u përmend me sinqeritet dhe me e pastruar emrin e Tij ,e kur ta pastroj në heshtje pra pa e përmend ai veç e ka përmend emrin e Allahut ,për shkak të seriozitetit dhe pastërtisë së emrit të Tij.

INSTIKTIVITETI I GJUMIT

Gjumi është shenjë e madhe .Zoti e ka krijuar për me zëvendësuar shenjën e ditës,kështu ka bërë kombinim të balancimit .Cila është e vërteta e asaj që thuhet se është begati dhe shenjë

Përgjigjja:Gjumi është begati e madhe prej begative të Allahut .Ti ndoshta e ngarkon dhe e angazhon veten për së tepërmi mirëpo nuk të len me vazhduar ashtu por thotë: Jo, mori fund, pusho , ndale punën tënde përkohësisht . Kjo është instiktiviteti i gjumit dhe mjeti i njeriut ,e mjeti punon ,pse ndoshta lodhesh , por prapë ti mundohesh e angazhon veten shumë,mirëpo vjen koha kur thot:Ndalu nuk është më kohë e përshtatshme për punë ,prit deri sa të të rikthehet fuqia dhe forca.

Gjumi është pushim ,për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë: A nuk e kemi bërë gjumin tuaj ,pushim për ju.

Kjo pra është prej begative të mëdha të njeriut .Dhe përderisa gjumi ia ndërpret njeriut lidhjen me këtë jetë është pushim. Subat do të thotë : ndërprerje. Të ka ndërpre prej punës dhe aktiviteti .mëshirë dhe përgatitje për njeriun për aktivitetin e mëtutjeshëm. Gjumi të humb vetëdijen ,ndërsa humbja e vetëdijes për një kohë të caktuar është begati e madhe. Nëse ti ke dhembje në një pjesë apo organ të trupit që në momentin kur të flesh ndalet dhembja e pas gjumit pra kut të zgjohesh prapë rifillon dhembja .Ky është argument se gjumi është mëshirë dhe qetësim i sëmundjeve dhe dhembjeve.

HALLALLET E ARIT TË FEMRAVE

A është hallall apo haram stolisja e hallhave të femrave me ajete Kur'anore?

Përgjigjja:Lejohet që në hallhallet të arit të jenë të shkruar ajete të Kur'anit apo fjala e Allahut, mirëpo atëherë femra duhet pasur kujdes t'i ketë ato kur të jetë e pastër e gjithashtu nuk lejohet që të hyjë në WC .

BOTA TJETËR

Si do të jetë bota tjetër.

Gjatë jetës tonë përjetojmë dy gjendje: jeta në gjumë dhe jeta e zgjuar; dhe a mund të thuhet se është e njëjtë gjendja (ligji) i gjumit me gjendjen (ligjin) zgjuar. Ne shohim se kanë dallim të madh edhe pse në të dy rastet ekziston jeta. Pra, kur themi: Vdekja është jetë e botës tjetër dhe në atë botë ka sistem tjetër të jetës ,patjetër duhet të besojmë ,sepse ti po sheh në gjumë deri sa sytë e tu po janë mbyllur ,pra ka mjete tjera të shikimit pos syrit ,me të cilat mund të shihen njerëzit ,„ngjyrat , dhe vendet. Kur kjo të ndodh atëherë kur në trupin e njeriut paraqitet vetëm një gurëzim i vogël. Po nëse na thuhet neve: Në varr ka jetë tjetër ,atëherë kur kjo jetë përfundon atëherë ajo jetë patjetër duhet me qenë më e fuqishme dhe më e fortë .Në ëndërr ushqehemi ,pimë ,ndiejmë ithëti, ëmbëlsirë,dhe kur të shohim ëndërrën e tregojmë gjatë edhe pse shkencërisht është e vërtetuar se ëndërra më e gjatë nuk zgjatë më shumë se shtatë sekonda ,pra kjo do të thotë se koha është mënjeluar thjesht nuk ka ekzistuar .Kështu ne shohim se në njërin anë një njeri sheh ëndërr që është në mesin e shokëve të tij ,qesh ,han ,gëzohet ,ndërsa tjetri në anën tjetër sheh ëndërr se armiqtë e tij e rrahin. As ky nuk ndien ,çka i ka ndodh tjetrit ,as

tjetri nuk di çka i ka ndodhë këtij.

Për këtë arsye Muhamedi a.s. na ka tërheq vërejtjen kur ka thënë : Ju do të vdisni sikurse do të flini e do të ringjalleni ,sikurse do të zgjoheni.

E përderisa ligji i gjumit ndryshon prej ligjit të jo gjumit njësoj edhe ligji i vdekjes ndryshon prej ligjit të jetës.

Me ndihmën e Allahut përfundoj pjesa e shtatë e librit,, Fetvatë e të nderuarit tonë Shejhut Muhamed Muteveli Shaëravijut dhe pason pjesa e tetë nëse dëshiron Allahu.